



Funded by
the European Union

JUSTAL

Technical Assistance to Support
the Implementation of the Crosscutting
Justice Strategy in Albania

Projekt i zbatuar nga:



DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS PËR TË RINJTË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Fletë informuese për të rinj (12-16 vjeç)



RECONNECT

**BINGHAM
CENTRE FOR
THE RULE
OF
LAW**



Leuven Centre
for Global
Governance Studies



Funded by
the European Union

JUSTAL

Technical Assistance to Support
the Implementation of the Crosscutting
Justice Strategy in Albania

Projekt i zbatuar nga:



DEMOKRACIA DHE SHTETI I SË DREJTËS PËR TË RINJTË NË BASHKIMIN EVROPIAN

Fletë informuese për të rinj (12-16 vjeç)

Botim i Ministrisë së Drejtësisë
publikuar me mbështetjen e projektit JUSTAL
(Asistenca Teknike në Mbështetje të Zbatimit të Strategjisë
Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri)

Tiranë 2024

RECONNECT

**BINGHAM
CENTRE FOR
THE
RULE
OF
LAW**





Funded by
the European Union

Ky botim është realizuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e Ministrisë së Drejtësisë dhe JUSTAL dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Heqje dorë nga përgjegjësia

Botimi në shqip u realizua me mbështetjen e projektit JUSTAL. Botimi origjinal është hartuar nga Qendra Bingham për Shtetin e së Drejtës, së bashku me Universitetin e Leuvenit, si pjesë e projektit RECONNECT “Të rilidhim Evropën me qytetarët e saj nëpërmjet demokracisë dhe shtetit të së drejtës”, të financuar nga BE-ja në kuadër të Horizon 2020. Projekti RECONNECT është financuar nëpërmjet Grantit nr. 770142. Dizajni grafik u realizua nga Dan Gould Design. Qendra Bingham për Shtetin e së Drejtës dhe Universiteti i Leuvenit nuk mbajnë përgjegjësi për botimin për Shqipërinë, si edhe për përmbajtjen e faqeve apo burimeve të tjera të listuara në të.

Përkthimi: Koço Bendo, Maniela Sota

Redaktimi: Julinda Beqiraj, Stela Suloti, Klesta Hysi

Layout: Ilir Kaso

Shtypur në shtypshkronjën: Kumi

© RECONNECT 2021

JUSTAL

Ministria e Drejtësisë

Blvd Zogu I-rë

Tiranë

E-mail: info@justal.eu

Web: www.justal.eu

HYRJE

Si pjesë e projektit kërkimor RECONNECT “Të rilidhim Evropën me qytetarët e saj nëpërmjet demokracisë dhe shtetit të së drejtës”

(www.reconnect-europe.eu), Qendra Bingham për Shtetin e së Drejtës, së bashku me Universitetin e Leuvenit, kanë përgatitur një komplet materialesh edukative për të rinjtë që jetojnë në Bashkimin Evropian.

Konceptet si shteti i së drejtës, demokracia dhe të drejtat e njeriut mund të jenë komplekse, por informimi mbi to nuk duhet të jetë domosdoshmërisht kështu! Këto materiale edukative përfshijnë gjithsej 10 tema për t’u dhënë mundësinë studentëve dhe mësuesve të përfshihen në diskutime mbi BE-në me njohuri mbi kuptimin dhe rëndësinë e koncepteve thelbësore evropiane si shteti i së drejtës, demokracia dhe të drejtat e njeriut. Materialet përfshijnë gjithashtu tematika që i drejtohen një grupmoshe më të re, si të drejtat e fëmijëve, migrimi, ndryshimet klimatike, mediat sociale dhe arsimi.

Për secilën nga këto 10 tema janë përgatitur:

- 1) fletë informuese për fëmijë të vegjël (shkolla fillore / afërsisht 9-11 vjeç)
- 2) fletë informuese për të rinj (shkolla e mesme / afërsisht 12-16 vjeç)
- 3) dhe disa shënime të shkurtra udhëzuese për mësuesit.

Në këtë broshurë, ne kemi mbledhur 10 fletë informuese të cilat u drejtohen të rinjve. Shënimet udhëzuese për mësuesit që shoqërojnë fletët informuese janë të disponueshme në faqen zyrtare të projektit në internet

(<https://reconnect-europe.eu/educators>).

Në varësi të aftësisë për të lexuar, fletët informuese mund të përdoren nga të rinjtë në mënyrë të pavarur ose gjatë diskutimit me mësuesin në klasë. Fletët informuese synojnë të shërbejnë si materiale

edukative për të dhjetë temat dhe, si të tilla, ato mund të përdoren më vete ose bashkë me burime të tjera mësimore si pjesë e edukatës qytetare më të gjerë në shkolla.

Materialet edukative në gjuhën angleze janë gjithashtu të disponueshme për t’u parë, shkarkuar dhe printuar në faqen zyrtare (<https://reconnect-europe.eu/youthresourcecentre/>).

Për studentët, profesionistët dhe studiues të tjerë të interesuar të çdo grupmoshe, projekti RECONNECT ofron kursin e hapur online, i cili përmban edhe njohuri bazë mbi demokracinë dhe shtetin e së drejtës në Evropë (<https://reconnect-europe.eu/mooc/>).

Shpresojmë që këto materiale edukative të jenë interesante dhe të vlefshme për ju.

Falënderojmë Dan Gould Design për dizajnin grafik (<https://www.dangould.co.uk>).


Qendra Bingham për Shtetin e së Drejtës dhe Universiteti i Leuvenit janë dy nga 18 organizatat partnere pjesë e projektit kërkimor RECONNECT “Të rilidhim Evropën me qytetarët e saj nëpërmjet demokracisë dhe shtetit të së drejtës” (www.reconnect-europe.eu). Projekti ka marrë financim nga programi “Kërkim dhe Inovacion Horizon 2020” i Bashkimit Evropian sipas Grantit nr. 770142.

Të dhënat e fletëve informuese i referohen materialit origjinal në anglisht, i cili është publikuar në vitin 2021. Në versionin shqip nuk janë reflektuar ndryshimet e mundshme të të dhënave pas vitit 2021. Botimi në shqip i Ministrisë së Drejtësisë është bërë i mundur nga projekti i asistencës teknike “JUSTAL” në mbështetje të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë, financuar nga Bashkimi Evropian.

TEMA 1: ÇFARË ËSHTË BE-JA?

1 ÇFARË ËSHTË BE-JA?

BE-ja është një organizatë e vendeve evropiane dhe “BE” do të thotë “Bashkimi Evropian”. Nga 50 vende në Evropë, 27 janë anëtare të BE-së. BE-ja funksionon paksa si një shtet, me vlerat, flamurin, bankën qendrore, valutën, kartëmonedhat, parlamentin dhe gjykatën e saj. Të gjithë shtetasit e vendeve anëtare të BE-së quhen shtetas të BE-së.



FAKTE PËRMBLEDHËSE

- Në BE jetojnë 446 milionë njerëz – popullsia e tretë më e madhe në botë, pas Kinës dhe Indisë.
- Në BE ka 24 gjuhë zyrtare dhe çdo vit më 26 shtator festohet Dita Evropiane e Gjuhëve.
- Lumi më i gjatë në BE është Danubi, i cili fillon në Gjermani dhe rrjedh nëpër 10 vende.
- Nga sipërfaqja, Franca është vendi më i madh në BE dhe Malta është vendi më i vogël.
- Vendi më i pasur në BE është Luksemburgu, ndërsa më i varfëri është Bullgaria.
- Qyteti më i madh në BE është Berlini (3.7 milionë banorë).
- Kryeqyteti i BE-së është Brukseli, i cili është njëkohësisht edhe kryeqyteti i Belgjikës.



SIMBOLET E BE-SË

- Flamuri evropian paraqet një rreth me 12 yje të artë në një sfond blu. Këto elemente përfaqësojnë vlerat e unitetit, bashkimit dhe harmonisë mes popujve të Evropës.
- Motoja e BE-së është “Të bashkuar në diversitet”, e cila ka të bëjë me bashkimin e evropianëve për të punuar për paqen dhe mirëqënien, si dhe për të ruajtur dhe zhvilluar kulturat, traditat dhe gjuhët e ndryshme në BE.
- Dita e Evropës, më 9 maj të çdo viti, përkujton paqen dhe unitetin në Evropë.
- BE-ja ka himnin e saj.


2 SI U KRIJUA BE-JA?

BE-ja i ka fillimet e veta në vitet '50 pas Luftës së Dytë Botërore. Fillimisht “vendet themeluese” ishin gjashtë: Gjermania, Franca, Italia, Luksemburgu, Belgjika dhe Holanda. Ndër të tjera, komuniteti u krijua për të ndihmuar në thyerjen e barrierave tregtare midis vendeve të Evropës, për të rritur konkurrencën midis vendeve anëtare dhe për të vendosur marrëveshje dhe standarde të përbashkëta bujqësore dhe tregtare nëpërmjet një tregu të vetëm të përbashkët. Që atëherë, janë bashkuar vende të tjera dhe komuniteti e ka ndryshuar emrin disa herë: Komuniteti Ekonomik Evropian (KEE), Komuniteti Evropian (KE), Bashkimi Evropian (BE).

Në vitin 1992, BE-ja u formua zyrtarisht nëpërmjet Traktatit të Mاستrihtit, i nënshkruar nga 12 shtete (Belgjika, Danimarka, Franca, Gjermania, Greqia, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Holanda, Portugalia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar – prandaj janë 12 yje të artë në flamurin e BE-së). Ç’është më e rëndësishmja, në bazë të Traktatit të Mاستrihtit u vendos hedhja në treg e një monedhe të përbashkët - EURO. Në vijim Traktati i Lisbonës, miratuar në vitin 2009, i dha BE-së edhe më shumë kompetenca.

Aktualisht BE-ja ka 27 shtete anëtare. Më 31 janar 2020, Mbretëria e Bashkuar u bë vendi i parë anëtar që u largua nga BE-ja dhe ky proces u quajt “Brexit”. Ndërkohë, BE-ja është në bisedime për pranimin e anëtarëve të rinj (vendet kandidatë) si p.sh. Shqipëria dhe Serbia.

Globalizimi dhe mënyra sesi bota është gjithnjë e më e ndërlidhur tregojnë se shumë çështje nuk prekin më vetëm një vend. Globalizimi krijon mundësi e sfida dhe BE-ja përpiqet të dalë me një përgjigje të përbashkët. Për shembull, politika tregtare e BE-së krijon më shumë mundësi tregtare për bizneset evropiane dhe u jep vendeve të BE-së më shumë forcë në negociata sesa po të negocionin më vete. Në mënyrë të ngjashme, BE-ja dha një përgjigje të përbashkët evropiane ndaj pandemisë COVID-19, duke përfshirë nxjerrjen e udhëzimeve për masat e ndalimit të përhapjes së virusit dhe mbështetjen e vaksinimit në vendet anëtare të BE-së.



3 CILAT JANË VLERAT E BE-SË?

Ka një sërë vlerash që janë të përbashkëta për të gjitha vendet e BE-së. Le t'i shikojmë ato:

DINJITETI I NJERIUT: Dinjiteti i njeriut ka të bëjë me vlerësimin dhe shfaqjen e respektit për të gjithë njerëzit për atë që ata janë, thjesht sepse ata janë qenie njerëzore. Dinjiteti i gjithsecilit duhet të respektohet dhe mbrohet pasi është baza reale për të drejtat themelore.

LIRIA: Liria e lëvizjes u jep shtetasve të BE-së të drejtën të lëvizin dhe të jetojnë brenda BE-së. Ekzistojnë gjithashtu liri të tjera, si e drejta për arsim dhe liria e fesë, që mbrohen nga Karta e të Drejtave Themelore të BE-së.

DEMOKRACIA: Në demokraci, qytetarët ndikojnë në mënyrën se si mund të drejtohet vendi nëpërmjet votës. Të jesh qytetar i BE-së do të thotë gjithashtu të gëzosh të drejta politike. Për shembull, të gjithë qytetarët e BE-së kanë të drejtë të kandidojnë për deputet dhe të votojnë në zgjedhjet për Parlamentin Evropian. Një shtetas gjerman, për shembull, mund të kandidojë dhe të votojë në Gjermani ose në Francë, nëse ai/ajo jeton atje.

SHTETI I SË DREJTËS: Shteti i së Drejtës është një nga vlerat kryesore në të cilën bazohet BE-ja. Ai përfshin një sërë elementësh, të cilët do t'i shqyrtojmë në një tjetër fletë informuese. Kjo nënkupton se ligji duhet të zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjithë dhe të gjithë duhet ta respektojnë atë, duke filluar nga qytetarët, te qeveria, dhe organet e tjera publike. Nëse ka shkelje të ligjit, duhet të sigurohet akses në drejtësi nëpërmjet gjykatave. Traktatet e BE-së, të cilat janë marrëveshje midis vendeve anëtare, përbëjnë bazën ligjore të BE-së. Gjykata e Drejtësisë e BE-së është gjykata më e lartë e Bashkimit Evropian dhe vendimet e saj duhet të respektohen dhe zbatohen.

TË DREJTAT E NJERIUT: Të drejtat e njeriut janë të drejtat dhe liritë që ne i kemi sepse jemi qenie njerëzore. Në BE, ato mbrohen nga Karta e të Drejtave Themelore të BE-së. Kjo nënkupton se të gjithë ne kemi të drejtën të trajtohem në mënyrë të barabartë pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, etnia ose origjina sociale, gjuha, feja ose besimi, aftësitë e kufizuara, moshë, apo orientimi seksual.

4 ÇFARË ËSHTË EURO?

BE-ja ka valutën e saj, Euron. Në BE, 19 nga 27 shtetet anëtare aktualisht përdorin Euron, pra shpesh nuk është më e nevojshme të shkëmbeni para kur udhëtoni nga një vend i BE-së në tjetrin (p.sh. nga Italia në Gjermani ose nga Franca në Belgjikë). Shtete të tjera si Danimarka ose Polonia për shembull, nuk përdorin Euron. "Eurozona" u krijua në vitin 2005 dhe është bashkim i të gjitha vendeve që përdorin Euron. Euro prodhohet nga Banka Qendrore Evropiane, selia e së cilës është në Frankfurt, Gjermani.



5

ÇFARË ËSHTË TREGU I PËRBASHKËT I BE-SË?

Tregu i përbashkët evropian është një nga tiparet dalluese të BE-së. BE-ja vepron si një territor pa kufij të brendshëm dhe barriera të tjera për lëvizjen e lirë ndërmjet shteteve anëtare, barriera të cilat zakonisht ekzistojnë ndërmjet shteteve.

Tregu i përbashkët bën të mundur që mallrat, shërbimet, kapitali dhe njerëzit të lëvizin lirisht nëpër BE. Mallrat janë objektet që njerëzit prodhojnë ose produkte që i rritin për t'i shitur (si lodrat, rrobat, kompjuterët ose ushqimet). Shërbimet janë ato çfarë njerëzit bëjnë për të tjerët (si shërbimet që ofrojnë mjekët, ndërtuesit, shoferët e autobusëve dhe parukierët). Të gjithë shtetasit e BE-së kanë gjithashtu të drejtën të jetojnë, punojnë, blejnë, studiojnë ose të dalin në pension jashtë vendit të tyre, në çdo vend tjetër të BE-së. Për shembull, një mësues nga Franca mund të japë mësim në frëngjisht në një shkollë në Suedi.

Një treg i përbashkët funksional nxit konkurrencën dhe tregtinë, përmirëson efikasitetin, rrit cilësinë dhe ndihmon në uljen e çmimeve.

Tregu i përbashkët evropian është një nga arritjet më të mëdha të BE-së. Ai ka krijuar rritje ekonomike dhe e ka bërë më të lehtë jetën e përditshme të bizneseve dhe konsumatorëve evropianë, duke vendosur njëkohësisht standarde të larta sigurie për konsumatorët dhe mbrojtjen e mjedisit. Tregu i përbashkët i BE-së ka 450 milionë konsumatorë dhe përfshin 22.5 milionë biznese të vogla dhe të mesme. Për të siguruar lëvizjen e lirë midis vendeve, Zona Shengen u krijua për banorët e disa shteteve - duke përfshirë edhe shtete jo anëtare të BE-së. Shtete anëtare të BE-së në Zonën Shengen janë: Austria, Belgjika, Estonia, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Malta, Holanda, Portugalia, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Republika Çeke, Danimarka, Hungaria, Polonia, dhe Suedia. Shtete jo anëtare të BE-së pjesë e Zonës Shengen janë: Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia dhe Zvicra. Banorët e shteteve të Zonës Shengen mund të lëvizin shumë më lehtë brenda kësaj zone pasi nuk kërkohet vizë ose paraqitje e pasaportës.



6

SI QEVERISET BE-JA?

27 shtetet anëtare bashkëpunojnë në kuadër të BE-së për të zgjidhur problematikat që prekin të gjithë qytetarët e BE-së, shpesh duke kapërcyer mosmarrëveshjet e tyre për të përballuar së bashku sfida të rëndësishme.

BE-ja qeveriset nga katër organe kryesore:

Parlamenti Evropian, me seli në Strasburg (Francë), Bruksel (Belgjikë) dhe Luksemburg; Këshilli Evropian, Komisioni Evropian dhe Këshilli i Bashkimit Evropian, të gjithë me seli në Bruksel (Belgjikë).

Këshilli Evropian përcakton drejtimin dhe prioritetet e përgjithshme të politikave të BE-së. Ai përbëhet nga udhëheqësit politikë (kryeministrat/ presidentët) të vendeve anëtare të BE-së

Komisioni Evropian, i cili mbron interesat e BE-së, propozon ligje të reja. **Parlamenti Evropian** dhe **Këshilli i Bashkimit Evropian** në vijim debatojnë dhe miratojnë ligjet e reja të propozuara nga Komisioni.

Këshilli i Bashkimit Evropian përbëhet nga ministra të qeverive kombëtare, ndërsa Parlamenti Evropian zgjidhet drejtpërdrejt. Zgjedhjet evropiane, ku qytetarët e BE-së zgjedhin anëtarët e Parlamentit Evropian, zhvillohen një herë në çdo pesë vjet. Pasi Parlamenti dhe Këshilli i Bashkimit Evropian vendosin për ligjet e BE-së, Komisioni punon për të siguruar që e drejta e BE-së të zbatohet siç duhet në shtetet anëtare.

Institucionet e tjera të BE-së përfshijnë **Bankën Qendrore Evropiane** në Frankfurt (Gjermani) dhe **Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian**, e cila ndodhet në Luksemburg. Gjykata jep vendime për një gamë të gjerë çështjesh që prekin jetën e qytetarëve të BE-së dhe interpreton të drejtën e BE-së për t'u siguruar që ligji i BE-së zbatohet në të njëjtën mënyrë në të gjitha shtetet anëtare.



KËSHILLI EVROPIAN



PARLAMENTI EVROPIAN



KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN



KOMISIONI EVROPIAN



GJYKATA E DREJTËSISË SË BE-SË



BANKA QENDRORE EVROPIANE

TEMA 2: CILAT JANË TË DREJTAT E MIA SI SHTETAS I BE-SË?

1

ÇFARË ËSHTË SHTETËSIA E BE-SË?

Shtetësia juaj zakonisht lidhet me vendin ku keni lindur. Përveç kësaj, nëse jeni shtetas i një prej 27 vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (BE), atëherë jeni gjithashtu shtetas i BE-së.

Shtetësia e BE-së u vendos zyrtarisht në vitin 1992, në bazë të Traktatit të Mاستrihtit. Do të diskutojmë në një fletë tjetër informuese se si u themelua BE-ja dhe sesi Traktati i Mاستrihtit është marrëveshja që themeloi BE-në. Të qenit shtetas i BE-së nuk e zëvendëson shtetësinë tuaj kombëtare, por e plotëson atë. Kjo do të thotë që shtetësia juaj fillestare mund të jetë, për shembull, franceze ose gjermane, por në të njëjtën kohë do të keni edhe shtetësinë e BE-së. Një referencë për BE-në do të shfaqet edhe në pasaportën tuaj gjermane ose franceze.

Të qenit shtetas i BE-së ju siguron një mori të drejtash, lirish dhe mbrojtjen juridike sipas së drejtës së BE-së, të cilat janë të vlefshme në çdo shtet të BE-së ku mund të ndodheni.



ÇFARË OFRON BE-JA?

- **Paqja** – BE-ja është përshkruar si “projekti më i suksesshëm i paqes në historinë njerëzore” dhe ka marrë Çmimin Nobel për Paqe në vitin 2012.
- **Tregu i përbashkët i BE-së** – Tregu i përbashkët bën të mundur që njerëzit, mallrat (sendet që njerëzit prodhojnë ose rritin për t'i shitur), shërbimet (ato që njerëzit bëjnë për të tjerët) dhe paratë të lëvizin lirshëm nëpër BE. Këto njihen si “katër liritë themelore” (lëvizja e lirë e njerëzve, mallrave, shërbimeve dhe kapitalit). Për shembull, një familje mund të blejë një makinë në Itali dhe të udhëtojë me të nëpër Francë, për të arritur vendbanimin në Austri. Po ashtu, nuk ka asnjë kufizim për lëvizjet e kapitalit apo komisionet për pagesat,
- **kështu që mund të transferoni aq para sa të dëshironi nga llogaria juaj bankare gjermane në llogarinë tuaj bankare italiane.**
- **Të Drejtat e Njeriut** – Të drejtat e njeriut janë të drejtat dhe liritë që ne i kemi sepse jemi njerëz. Në BE, ato mbrohen nga Karta e të Drejtave Themelore të BE-së.
- **Rregullat e sigurisë** – Këto rregulla nënkuptojnë që të gjithë shtetasit e BE-së kanë akses në produkte dhe shërbime të garantuara sipas standarteve të sigurisë të përcaktuara nga BE, si për shembull në lidhje me ushqimet, medikamentet, lodrat dhe informacionet në internet.
- **Telefonat celularë** – Mund ta përdorni telefonin tuaj pa paguar para shtesë kudo që të jeni në BE (roaming falas).

2

ÇFARË TË DREJTASH KANË SHTETASIT E BE-SË?

Të shikojmë disa nga të drejtat ekonomike dhe politike që kanë shtetasit e BE-së:

♥ TË TRAJTOHEN NË MËNYRË TË BARABARTË

Shtetasit e BE-së kanë të drejtën të mos trajtohen ndryshe për shkak të shtetësisë së tyre. Ky quhet mos-diskriminim. Mos harroni, shtetësia juaj është zakonisht ajo e vendit ku keni lindur dhe shtetësia e BE-së i shtohet asaj.

🏠 TË LËVIZIN DHE TË JETOJNË NË BE

Shtetasit e BE-së kanë të drejtë të lëvizin lirshëm në BE dhe të jetojnë, të punojnë, të studiojnë, të marrin trajtim shëndetësor, të kërkojnë punë ose të dalin në pension kudo në BE.

🔑 T'I PROPOZOJNË LIGJE TË REJA KOMISIONIT EVROPIAN

Shtetasit e BE-së mund t'i drejtohen Komisionit Evropian për të propozuar ligje të reja nëpërmjet Nismës Qytetare Evropiane. Pasi mbështetja për një nismë të ketë arritur në 1 milion nënshkrime nga shtetasit e të paktën 7 vendeve të BE-së, Komisioni do të vendosë se çfarë veprimi do të ndërmarret. Nisma Qytetare Evropiane është një mënyrë unike që qytetarët të ndihmojnë drejtpërdrejt në formësimin e BE-së.

😞 TË BËJNË PETICIONE DHE ANKESA

Një peticion mund t'i dërgohet Parlamentit Evropian për të trajtuar një problematikë personale ose për të ngritur një çështje që është me interes publik. Për më tepër, ankesat mund t'i dërgohen Avokatit të Popullit (Ombudsman) të BE-së për sjellje të paligjshme të një institucioni të BE-së. Nëse kontaktoni drejtpërdrejt institucionet e BE-së, ju keni të drejtë të merrni një përgjigje në cilëndo nga 24 gjuhët zyrtare të BE-së.

🗳️ TË VOTOJNË DHE MARRIN PJESË NËZGJEDHJE

Në demokraci, qytetarët kanë zë në mënyrën se si mund të drejtohet vendi dhe e shprehin këtë nëpërmjet votës. Të jesh shtetas i BE-së do të thotë gjithashtu të gëzosh të drejta politike. Qytetarët e BE-së kanë të drejtë të votojnë dhe të kandidojnë në zgjedhjet bashkiake në vendin e BE-së ku ata jetojnë. Një shtetas hungarez, për shembull, mund të kandidojë dhe të votojë në Spanjë nëse ai/ajo jeton atje.

Përveç zgjedhjeve kombëtare (zgjedhjeve vendore ose zgjedhjeve për anëtarët e parlamenteve kombëtare, si në Austri, Poloni ose Maltë) ka edhe zgjedhje evropiane për anëtarët e Parlamentit Evropian.



Zgjedhjet evropiane zhvillohen çdo pesë vjet. Në zgjedhjet evropiane të vitit 2019, shtetasit e BE-së zgjodhën 751 anëtarë të Parlamentit Evropian (deputetë). Në këto zgjedhje votuan mbi 250 milionë shtetas të BE-së. Zgjedhjet e ardhshme evropiane do të zhvillohen në vitin 2024.

Nga 500 milionë qytetarë, 375 milionë kanë të drejtë vote.



**FAKT
PËRMbledhës**



TË MBROHEN KUR UDHËTOJNË JASHTË BE-SË

Një ambasadë ose konsullatë është baza ose selia që një vend ngre në një vend tjetër. Një nga rolet e saj është të mbrojë dhe të ndihmojë shtetasit e saj kur ata janë duke udhëtuar jashtë vendit. Qytetarët e BE-së mund të kërkojnë ndihmë nga ambasada ose konsullata e një vendi tjetër anëtar të BE-së kur ata janë jashtë BE-së dhe vendi i tyre atje nuk ka ambasadë ose konsullatë. Për shembull, nëse ju jeni italian dhe u ka humbur pasaporta ose ua kanë vjedhur gjatë pushimeve në një vend jashtë BE-së dhe nuk ka ambasadë ose konsullatë italiane atje, atëherë mund të shkoni në ambasadën ose konsullatën e çdo vendi tjetër anëtar të BE-së dhe të kërkonin ndihmë për lëshimin e një pasaporte me procedurë urgjente.

3

SI MBROHEN TË DREJTAT E MIA?

Disa nga të drejtat e shtetasve të BE-së mund t'i gjejmë në Kapitullin 5 të Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së. Qeveritë e vendeve të BE-së duhet të respektojnë mbi 50 Nenet e Kartës së të Drejtave Themelore të BE-së.

Disa nga të drejtat e shtetasve të BE-së mund t'i gjejmë edhe në një traktat të rëndësishëm të quajtur Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Traktatet janë marrëveshje të bëra midis vendet anëtare të BE-së. Të drejtat e shtetasve të BE-së parashikohen gjithashtu në të ashtuquajturat ligje të BE-së të miratuara nga Parlamenti Evropian (rregulloret dhe direktivat), për shembull për mbrojtjen e të dhënave personale, për mbrojtjen nga diskriminimi në punësim, ose për të drejtën e shtetasve jo të BE-së për t'u ribashkuar me anëtarët e familjes së tyre që janë shtetas të BE-së.

Ankesat për zbatimin e papërshtatshëm të Kartës, Traktateve dhe ligjeve të BE-së nga qeveritë dhe nga institucionet e BE-së mund të paraqiten para Gjykatës së Drejtësisë së BE-së.



TEMA 3: ÇFARË JANË TË DREJTAT E NJERIUT?

1 NGA RRJEDHIN TË DREJTAT E NJERIUT?

Ne gëzojmë të drejtat e njeriut sepse jemi qenie njerëzore. Këto të drejta nuk mund të na hiqen, sepse ato janë pjesë e secilit prej nesh që kur kemi lindur. Ato zbatohen pavarësisht se nga jemi, në çfarë besojmë dhe si zgjedhim ta jetojmë jetën tonë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUDNJ) është dokumenti bazë ku renditen të drejtat dhe liritë e njeriut. Ajo quhet “universale” sepse të drejtat e renditura në të vlejnë për çdo qenie njerëzore në botë. Deklarata përcakton se çdokush ka të drejtën të gëzojë të gjitha këto të drejta dhe liri universale “pa asnjë lloj dallimi, si: raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, bindjet politike apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, pasuria, lindja apo ndonjë status tjetër”. DUDNJ është miratuar shekullin e kaluar më 10 dhjetor 1948 nga Organizata e Kombeve të Bashkuara (OKB). Ajo parashikoi për herë të parë të drejtat e njeriut që duhet të mbrohen në mbarë botën.



FAKTE PËRMbledhëse

- Në vitin 1945, pas Luftës së Dytë Botërore, në San Francisko (SHBA) OKB-ja u themelua për të promovuar paqen dhe sigurinë. Tani ajo ka 193 Shtete Anëtare, pothuajse të gjitha vendet në botë.
- Tashmë DUDNJ është dokumenti më i përkthyer në botë, në më shumë se 500 gjuhë.
- Përvjetori i DUDNJ, 10 dhjetori, është Dita e të Drejtave të Njeriut.

DUDNJ ka hedhur bazat për dokumentet e të drejtave të njeriut të përshtatura për rajone specifike të botës, si: Afrika, dy Amerikat, Azia dhe Evropa. Për shembull, Këshilli i Evropës ka Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila u miratua më 4 nëntor 1950 në Romë (Itali).

2

CILAT JANË TË DREJTAT E MIA?

Neni 1 i DUDNJ-së parashikon: “Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në dinjitet dhe të drejta”. Kjo është baza për të gjitha të drejtat e njeriut të renditura në DUDNJ, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe dokumentet e tjera të të drejtave të njeriut.

Më poshtë jepen disa shembuj të të drejtave të njeriut, të cilat duhet t'i gëzojë çdo qenie njerëzore:

	E drejta për jetën		E drejta për t'u martuar dhe për të krijuar familje
	E drejta për liri dhe siguri		E drejta e pronës
	E drejta e ndalimit të skllavërisë		Liria e fesë dhe besimit
	E drejta e ndalimit të torturës		E drejta e lirisë së mendimit dhe e shprehjes
	E drejta për mosdiskriminim dhe mbrojtje të barabartë nga ligji		E drejta e tubimit paqësor dhe asocimit
	Ndalimi i arrestimit ose burgimit arbitrar		E drejta e pjesëmarrjes në qeverisje dhe në zgjedhje të lira
	E drejta për një gjykim të drejtë		E drejta për punë
	E drejta për prezumimin e pafajësisë		E drejta për pushim dhe kohë të lirë
	E drejta për jetë private dhe familjare		E drejta për ushqim, veshmbathje, strehim, kujdes mjekësor dhe shërbime sociale
	E drejta për lirinë e lëvizjes		E drejta për arsimim
	E drejta për të kërkuar dhe për të gëzuar azil		E drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore të komunitetit
	E drejta e një shtetësie		

Ndonjëherë, të drejtat e njeriut grupohen në dy kategori: (1) të drejtat civile dhe politike, dhe (2) të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore.

Të drejtat civile dhe politike kanë të bëjnë me të jetuarit të lirë nga shtypja dhe ndërhyrja e qeverisë. Ato përfshijnë, për shembull, të drejtën për jetën, të drejtën për liri dhe siguri, lirinë e mendimit, lirinë e tubimit paqësor, të drejtën për të mos u torturuar dhe të drejtën për të votuar. Për shembull, nëse akuzoheni për kryerjen e një krimi, keni të drejtë të konsideroheni i pafajshëm derisa të provohet fajësia juaj: kjo quhet e drejta e prezumimit të pafajësisë.

Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore kanë të bëjnë me plotësimin e nevojave themelore të jetës njerëzore. Ato përfshijnë të drejtën për ushqim, veshmbathje dhe strehim, të drejtën për kujdes mjekësor, të drejtën për punë dhe të drejtën për arsim. Për shembull, e drejta për arsim nënkupton që qeveria duhet të bëjë të mundur që ju të shkoni në shkollë pa pagesë. Po ashtu, e drejta

për punë nënkupton që qeveria duhet t'ju mbrojë nga papunësia dhe t'ju mundësojë të punoni në kushte të favorshme. Njerëzit që bëjnë të njëjtën punë duhet të paguhën në mënyrë të barabartë.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut përfshin të dyja grupet e të drejtave, ndërsa **Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut** përqendrohet tek të drejtat civile dhe politike. Në ditët e sotme, shumë njerëz nuk e bëjnë më dallimin midis dy kategorive të të drejtave.

Të gjitha të drejtat e njeriut **janë të pandashme dhe të ndërrueshme**. OKB-ja ka shpjeguar se “Kjo do të thotë se një grup të drejtash nuk mund të gëzohet plotësisht pa tjetrin... përparimi në të drejtat civile dhe politike e bën më të lehtë ushtrimin e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore”. Kështu, për shembull, nëse ju hiqet liria në mënyrë të paligjshme, kjo do të ndikojë në gëzimin e të drejtave tuaja ekonomike, sociale dhe kulturore, si e drejta për punë dhe e drejta për arsimim.

3

ÇFARË MUND TË BËNI NËSE MENDONI SE JANË SHKELUR TË DREJTAT TUAJA?

Qeveria e vendit tuaj është përgjegjëse për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave tuaja. Në shumicën e rasteve, të drejtat e njeriut të përmënuara më sipër parashikohen gjithashtu në kushtetutën e vendit tuaj. Nëse mendoni se të drejtat tuaja janë shkelur ose cenuar (për shembull, nëse jeni keqtrajtuar ose ndëshkuar gabimisht nga policia), ju mund të ankoheni në gjykatat e vendit tuaj.

Për shembull, nëse jetoni në Evropë (përfshirë edhe Shqipëria) dhe ende mendoni se nuk u është dhënë një vendim i drejtë nga një gjyqtar i vendit tuaj, mund ta çoni çështjen tuaj kundër vendit tuaj në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg (Francë). Ju mund ta shkruani ankesën tuaj në një gjuhë zyrtare të cilitdo prej 47 vendeve anëtare të Këshillit të Evropës. Një ose disa gjyqtarë, të ardhur nga të gjitha vendet anëtare, do të shqyrtojnë në vijim çështjen tuaj dhe do të vendosin nëse vendi juaj i ka respektuar të drejtat tuaja. Nëse Gjykata vendos në favorin tuaj, do t'ju vihet në vend e drejta, duke përfshirë ndoshta vlera monetare si kompensim për dëmin që keni pësuar. Gjykata gjithashtu mund të urdhërojë qeverinë tuaj që të garantojë se nuk do të përsëritet i njëjti problem.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut aktualisht ka 47 gjyqtarë, një nga çdo Shtet Anëtar. Megjithatë, gjyqtarët nuk përfaqësojnë vendin e tyre; ata janë të gjithë të pavarur dhe veprojnë në interes të drejtësisë. Detyra e tyre është të garantojnë që çështja juaj të shqyrtohet drejt dhe të merret një vendim i drejtë.



FAKT PËRMBLEDHËS

Që nga themelimi i saj në vitin 1959, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka dhënë mbi 23,000 vendime.



4

ÇFARË VENDI ZË KARTA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE?

Karta e BE-së për të Drejtat Themelore përmban të drejtat themelore të çdo personi në BE. Duke i përfshirë të drejtat në një dokument, ajo i bën ato më të dukshme. Karta është e detyrueshme si për shtetet anëtare të BE-së, ashtu edhe për vetë BE-në, dhe të drejtat e përcaktuara në Kartë mund të ngrihen para gjykatave kombëtare.

Karta e të Drejtave Themelore të BE-së shpesh ngatërrohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të dy dokumentet mbulojnë të drejta dhe liri të ngjashme, por ka disa dallime të rëndësishme...



KARTA E BASHKIMIT EVROPIAN PËR TË DREJTAT THEMELORE

Komuniteti, që ne e njohim sot si BE, i ka fillimet e veta në vitet '50 pas Luftës së Dytë Botërore. Tashmë BE-ja ka 27 vende anëtare (Shqipëria nuk bën pjesë por ka kandiduar për anëtarësim).

Karta e të Drejtave Themelore u hartua nga BE në vitin 2000 dhe përfaqëson deklaratën e BE-së për të drejtat e njeriut.

Karta interpretohet nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në Luksemburg.

Vetë BE-ja dhe 27 shtetet anëtare të BE-së duhet të respektojnë të drejtat e parashikuara në Kartë.

Më 31 janar 2020, Mbretëria e Bashkuar u largua nga BE-ja. Ishte vendi i parë anëtar që u largua nga BE-ja dhe kjo u quajt "Brexit". Pas Brexit-it, Karta nuk zbatohet më për Mbretërinë e Bashkuar.

KONVENTA EVROPIANE E KËSHILLIT TË EVROPËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Këshilli i Evropës u themelua në vitin 1949 dhe ai përbëhet nga 47 vende anëtare (përfshirë edhe Shqipëria). Ai nuk është pjesë e Bashkimit Evropian, por të 27 vendet anëtare të BE-së janë gjithashtu anëtare të Këshillit të Evropës.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut u hartua nga Këshilli i Evropës mbi 50 vjet më parë, në vitin 1950.

Konventa interpretohet nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në Strasburg (Francë).

47 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës, duke përfshirë 27 vendet anëtare të BE-së, janë palë në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Megjithatë, vetë BE-ja nuk është (ende) palë në Konventë.

Mbretëria e Bashkuar mbetet anëtare e Këshillit të Evropës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut zbatohet ende për Mbretërinë e Bashkuar.

TEMA 4: ÇFARË ËSHTË SHTETI I SË DREJTËS?

1

ÇFARË ËSHTË SHTETI I SË DREJTËS?

Shteti i së Drejtës ka fituar jehonë dhe njohje globale dhe është një nga vlerat kryesore mbi të cilat bazohet Bashkimi Evropian. Ai përmban një sërë elementësh, të cilët mund t'i shohim më poshtë.


BARAZIA PARA LIGJIT

- Kjo do të thotë se rregullat duhet të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë.
- Të gjithë duhet të respektojnë rregullat, si qytetarët ashtu edhe qeveria dhe organet e tjera publike. Askush nuk është mbi ligjin!
- Të gjithë duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, megjithatë, mund të ndodhë që njerëzit të trajtohen ndryshe, nëse ka një arsye reale dhe të rëndësishme për ta bërë këtë (për shembull, ka rregulla të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve).



LIGJE TË QARTA, TË BESUESHME DHE TRANSPARENTE

- Të gjitha ligjet dhe rregullat duhet të jenë të qarta, të besueshme dhe transparente.
- Kjo do të thotë që njerëzit gjithmonë duhet të dinë dhe të kenë besim në atë çfarë parashikojnë rregullat për ta - cilat janë të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre, çfarë mund të bëjnë dhe çfarë nuk mund të bëjnë dhe cilat do të jenë pasojat, nëse shkelin rregullat.
- Gjithashtu, kjo do të thotë që njerëzit duhet të kenë mundësi t'i gjejnë lehtësisht ligjet dhe të vihen në dijeni për çdo ndryshim në kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për ndryshimin. Nuk duhet të ekzistojnë ligje sekrete!



LIGJBËRJA DHE USHTRIMI I KOMPETENCAVE

- Të gjitha ligjet dhe rregullat duhet të bëhen në mënyrë të drejtë dhe të hapur. Zhvillimi i diskutimeve rreth çështjeve rregullatore ligjore është pjesë e të jetuarit në demokraci dhe opinionet e ndryshme duhet të dëgjohen.
- Qeveria dhe organet e tjera publike duhet të ushtrojnë (ose përdorin) kompetencat që u janë dhënë në mënyrë të drejtë dhe brenda kufijve të përcaktuar në rregulla.
- Shtetet duhet gjithashtu të respektojnë rregullat e përcaktuara në të drejtën ndërkombëtare. Për shembull, 27 vendet anëtare duhet të respektojnë rregullat e Bashkimit Evropian.

TË DREJTAT E NJERIUT

- Rregullat duhet të mbrojnë të drejtat e njeriut. Ne gëzojmë të drejtat e njeriut sepse jemi qenie njerëzore. Këto të drejta nuk mund të na hiqen, sepse ato janë pjesë e secilit prej nesh që kur kemi lindur. Të drejtat e njeriut zbatohen pavarësisht se nga jemi, në çfarë besojmë dhe si zgjedhim ta jetojmë jetën tonë.
- Të drejtat e njeriut përfshijnë, për shembull, të drejtën për jetën, të drejtën për një gjykim të drejtë, të drejtën për jetë private dhe familjare, lirinë e shprehjes, të drejtën për arsimim dhe të drejtën për ushqim, veshmbathje, strehim dhe kujdes mjekësor.
- Shteti i së Drejtës ndihmon gjithashtu që të drejtat tona të bëhen realitet. Për shembull, nëse qeveria shkel të drejtat e njeriut, ne duhet të kemi akses në sistemin e drejtësisë.



ÇFARË ËSHTË “NDARJA E KOMPETENCAVE” (“SEPARATION OF POWERS”)?

Ligjet i bën ligjvënësi (parlamenti); ekzekutivi (qeveria) përcakton politikën dhe mundëson zbatimin e ligjit në praktikë; dhe gjyqësori (gjykatat) interpreton dhe gjykon mbi zbatimin e ligjit për çështjet e përcjella në gjykata duke mundësuar akses në drejtësi për të gjithë.

“Ndarja e kompetencave” është thelbësore për Shtetin e së Drejtës. Kjo kërkon që tre hallkat e shtetit (parlamenti, qeveria dhe gjykatat) të operojnë të ndara dhe të pavarura nga njëra-tjetra. Kështu mbrohen liritë e qytetarëve dhe institucionet kanë një sistem “kontrolli dhe balance” ndaj njëra-tjetrës në përdorimin e kompetencave.

DREJTËSI

TË DREJTAT E NJERIUT

AKSESI NË DREJTËSI

- Të gjithë duhet të kenë akses në drejtësi nëse kanë një problem ligjor. Për shembull, të gjithë duhet të kenë mundësi që t'i drejtohen gjykatës për të kundërshtuar vendimet e qeverisë që u shkelin të drejtat e njeriut.
- Akses në drejtësi funksionon mirë vetëm nëse zhvillohet një proces gjyqësor i drejtë dhe i hapur.
- Gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm. Kjo do të thotë që gjyqtarët nuk duhet të ndikohen nga presionet e jashtme dhe njerëzit duhet të kenë besim se vendimet e tyre janë të drejta dhe në përputhje me rregullat ligjore.



PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM AKSESI NË DREJTËSI?

Organizata e Kombeve të Bashkuara thotë se “Aksesi në drejtësi është një parim bazë i shtetit të së drejtës. Në mungesë të aksesit në drejtësi, njerëzve nuk do të mund t'u dëgjohet zëri, ata nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, të sfidojnë diskriminimin ose t'i kërkojnë llogari vendimmarrësit”.

(Burimi: Faqja e internetit e Kombeve të Bashkuara “Kombet e Bashkuara dhe Shteti i së Drejtës: Aksesi në Drejtësi”)

2 SI MUND TË NA NDIHMOJË SHTETI I SË DREJTËS?

Të shikojmë si mund të gjejë zbatim Shteti i së Drejtës në një sërë situatash:

BARAZIA PARA LIGJIT

Imagjinoni sikur të ekzistojë një rregull në vendin tuaj që thotë se gratë dhe vajzat duhet të paguhet 15% më pak se burrat dhe djemtë për të kryer të njëjtën punë.

- Kjo është e padrejtë dhe shkel të drejtat e njeriut. Gratë dhe vajzat duhet të paguhet njësoj si burrat dhe djemtë, kur bëjnë të njëjtën punë.
- Nëse gratë dhe vajzat trajtohen ndryshe, **sepse** janë gra dhe vajza, ato duhet të kenë mundësi që t'i drejtohen për ankesë një gjykate dhe të dëmshpërblehen për trajtimin e padrejtë të tyre.





LIGJE TË QARTA, TË BESUESHME DHE TRANSPARENTE

Imagjinoni sikur, për shkak të pandemisë COVID-19, të ekzistojë një ligj në vendin tuaj që thotë se u lejohet të takoheni vetëm në grupe prej gjashtë personash dhe se do të gjobiteni me 1000 Euro nëse shkelni këtë rregull.

- Është e rëndësishme që rregullat e ligjit të jenë të qarta, të besueshme dhe transparente – A mund t'i identifikoni lehtësisht këto rregulla? A është e qartë se çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet të bëni?

LIGJBËRJA DHE USHTRIMI I KOMPETENCAVE

Policia ka kompetenca t'ju "ndalojë dhe kontrollojë", për shembull nëse ka arsye për të menduar se ju mbani me vete drogë të paligjshme, një armë ose një send të vjedhur. Tani, imagjinoni sikur policia t'ju ndalojë dhe kontrollojë pa arsye, por thjesht për shkak të ngjyrës së lëkurës tuaj.

- Ky është diskriminim dhe nuk përfshihet brenda rregullave që përcaktojnë kompetencat e policisë. Policia nuk duhet t'ju ndalojë dhe kontrollojë thjesht për shkak të gjinisë ose racës tuaj.
- Nëse jeni ndaluar pa shkaqe të arsyeshme ose jeni trajtuar në mënyrë të padrejtë, mund të bëni një ankesë kundër policisë dhe, në raste të caktuara, mund të shkoni në gjykatë për të kërkuar dëmshpërbim.

AKSESI NË DREJTËSI

Imagjinoni sikur të jeni akuzuar se keni vjedhur diçka në një dyqan, gjë që nuk është e vërtetë. Jeni arrestuar nga policia, akuzoheni për këtë krim dhe dërgoheni menjëherë në gjykatë. Nuk ju është dhënë mundësia për një avokat. Gjyqtari, i cili është një i afërm i pronarit të dyqanit, ju shpall fajtor pa kërkuar të dijë versionin tuaj të ngjarjes.

- Ju gëzoni të drejtën për një gjykim të drejtë, ç'ka do të thotë se duhet të keni kohë të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen tuaj; duhet të keni akses në ndihmë juridike (mund të

- Për shembull, a aplikohet rregulli si në shtëpi, po ashtu edhe në hapësirat publike? A aplikohet rregulli si në mjedise të brendshme po ashtu edhe jashtë? A llogaritet numri i bebeve apo fëmijëve nën moshën 5 vjeç në numrin total të njerëzve? A aplikohet rregulli edhe për dasmat?
- Është gjithashtu e rëndësishme që çdo ndryshim ligjor të bëhet i ditur për publikun në kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur për ndryshimin.

TË DREJTAT E NJERIUT

Qeveria e vendit tuaj është përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtën tuaj për arsim. Këtu përfshihet edhe e drejta për arsim fillor falas. Fatkeqësisht, në mbarë botën, shumë fëmijëve nuk u sigurohet kjo e drejtë.

- Ju mund t'i ndihmoni fëmijët të njohin të drejtën e tyre për arsim dhe mund të ndërrojnë fushatë ndërgjegjëse që qeveria të garantojë shkollën fillore falas për të gjithë fëmijët në vendin tuaj.
- Nëse mendoni se e drejta juaj për arsim është shkelur, mund t'i drejtoheni gjykatës.

merrni ndihmë juridike falas nëse nuk përballoni dot shpenzimet, pasi kjo është e nevojshme në interes të drejtësisë); si edhe duhet t'ju jepet mundësia të tregoni versionin tuaj të ngjarjes. Gjithashtu, keni të drejtën të quheni të pafajshëm derisa të provoheni fajtor.

- Gjithashtu, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të paanshëm, që do të thotë se ata duhet të jenë të pafshueshëm nga ndërhyrjet dhe presionet e jashtme, si dhe nuk duhet të kenë asnjë konflikt interesi në lidhje me gjykimin e çështjes.

3

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM SHTETI I SË DREJTËS NË BASHKIMIN EVROPIAN?

Shteti i së Drejtës është një nga vlerat kryesore mbi të cilat bazohet BE-ja. Kjo përcaktohet në Nenin 2 të Traktatit për Bashkimin Evropian, i cili thotë: “Bashkimi bazohet në vlerat e respektimit të dinjitetit njerëzor, lirisë, demokracisë, barazisë, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat e personave që u përkasin pakicave”.

Shteti i së Drejtës konsiderohet si thelbësor për mbrojtjen e vlerave të tjera kryesore të BE-së, siç janë të drejtat e njeriut dhe demokracia, si dhe për të rritur besimin midis shteteve anëtare. Respektimi i Shtetit të së Drejtës është gjithashtu i rëndësishëm për zbatimin e mirë të së drejtës të BE-së. Për shembull, vendet, ku respektohen më shumë rregullat e BE-së që mbrojnë mjedisin, janë ato ku Shteti i së Drejtës është më i konsoliduar. Ai është gjithashtu i rëndësishëm për funksionimin efikas të tregut të përbashkët të BE-së, i cili mundëson lëvizjen e lirë në BE të mallrave, shërbimeve, kapitalit dhe njerëzve. Vendet që respektojnë Shtetin e së Drejtës janë gjithashtu më tërheqëse për bizneset, sepse të drejtat dhe përgjegjësitë e tyre janë të qarta dhe sepse mosmarrëveshjet zgjidhen në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me rregullat. Kjo do të thotë të kesh një “mjedis biznesi miqësor për investimet”.



SI E PËRKUFIZON BASHKIMI EVROPIAN SHTETIN E SË DREJTËS?

Bashkimi Evropian (BE) thotë se Shteti i së Drejtës përfshin “parime të tilla si ligjshmëria, që nënkupton një proces transparent, llogaridhënës, demokratik dhe pluralist në miratimin e ligjeve; mbrojtja juridike; ndalimi i ushtrimit arbitrar të pushtetit ekzekutiv; mbrojtja juridike efikase nga gjykata të pavarura dhe të paanshme, kontrolli kushtetues i ligjeve duke përfshirë edhe kontrollin mbi respektimin e të drejtave themelore; ndarja e kompetencave; dhe barazia para ligjit”.

Burimi: Komunikata e Komisionit Evropian “Forcimi i Mëtejshëm i Shtetit të së Drejtës brenda Bashkimit” (prill 2019).





ÇFARË ËSHTË “DOBËSIMI I SHTETIT TË SË DREJTËS”* NË BE?

Të gjitha vendet anëtare të BE-së përballen me sfida të natyrave të ndryshme në lidhje me Shtetin e së Drejtës. “Dobësimi i Shtetit të së Drejtës”* i referohet situatave ku shtetet qëllimisht dobësojnë sistemin e “kontrollit dhe balancave”, i cili zakonisht shërben për të garantuar llogaridhënien e atyre që janë në pushtet. Për shembull, shtetet mund të përpiqen të dobësojnë 1) të drejtat e njeriut si liria e shprehjes dhe liria e medias; 2) aksesin në drejtësi dhe pavarësinë e gjyqtarëve; dhe 3) sistemin zgjedhor, në mënyrë që partitë e

tjera politike ta kenë të vështirë të sfidojnë me sukses partinë në pushtet.

BE-ja mund të ndërmarrë masa ndaj një vendi, duke përfshirë pezullimin e të drejtës së votës në institucionet e BE-së, nëse mendon se ka “një shkelje serioze dhe të vazhdueshme” të vlerave kryesore të BE-së, siç është Shteti i së Drejtës. Kjo është përcaktuar në nenin 7 të Traktatit për Bashkimin Evropian.

* Koncepti në anglisht është “rule of law backsliding”.

“Shteti i së Drejtës” gjendet në kushtetutat e 16 prej 27 vendeve anëtare të BE-së. Megjithatë, elementë të Shtetit të së Drejtës (si aksesin në drejtësi dhe barazia para ligjit) shfaqen në të gjitha kushtetutat e 27 vendeve anëtare të BE-së.

Shteti i së Drejtës është një nga vlerat kryesore të BE-së, por në shtetet anëtare ky koncept ka emërtime të ndryshme. Për shembull, Stato di diritto (Itali), Etat de droit (Francë), Rechtsstaat (Gjermani), Estado de derecho (Spanjë), Saltna

tad Dritt (Maltë), Jogállamiság (Hungari), Praworzqdnosci (Poloni).

Në vitin 2019, BE-ja zhvilloi anketimin e Eurobarometrit në të gjitha shtetet anëtare në lidhje me Shtetin e së Drejtës. Ky anketim tregoi se Shteti i së Drejtës gëzon mbështetje të konsiderueshme nga të anketuarit si në shtetin e tyre, ashtu edhe në BE. Për më tepër, shumica e të anketuarve u përgjigjën se Shteti i së Drejtës në vendin e tyre kishte nevojë për përmirësim.

TEMA 5: ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?

1

ÇFARË ËSHTË DEMOKRACIA?

Demokracia është një nga format e drejtimit të një vendi. Thuhet se demokracia e ka zanafillën në Greqinë e Lashtë dhe fjala demokraci vjen nga dy fjalë greke që na ndihmojnë të kuptojmë se çfarë do të thotë:

DEMOS - POPULL KRATOS - SUNDIM ose PUSHTET

Pra, demokracia në thelb do të thotë “pushtet i popullit” ose “sundim i popullit”. Kjo do të thotë që njerëzit e kanë vetë në dorë se si do të qeverisen, për shembull, duke votuar në zgjedhje liderin e tyre politik. Pra, është fuqia e shumicës.

Diktatura është e ndryshme nga demokracia. Diktaturat janë forma drejtimi të një vendi, ku një person ose një grup i caktuar ka kontrollin mbi vendin dhe mund të veprojë siç e mendojnë ata. Pra, është fuqia e pakicës. Njerëzit që jetojnë në diktaturë zakonisht nuk kanë shumë të drejta apo liri.

FAKTE PËRMbledhëse

- Demokracia e parë në botë thuhet se e ka origjinën në Athinën e lashtë (Greqinë e sotme) rreth shekullit V para erës së re.
- Sot, shumica e vendeve në botë e përshkruajnë veten si demokratike dhe demokracia është një nga vlerat thelbësore të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
- Dita Ndërkombëtare e Demokracisë festohet më 15 shtator të çdo viti.
- Një përkufizim popullor i demokracisë është bërë nga Abraham Lincoln, ish-President i SHBA-së, në vitin 1863: “qeveria e popullit, nga populli, për popullin”.

DEMOKRACIA PËRFAQËSUESE PËRKUNDREJT ASAJ TË DREJTPËRDREJTË

Në demokracinë përfaqësuese njerëzit zgjedhin përfaqësuesit e tyre për të drejtuar vendin dhe për të marrë vendime në emër të tyre, në vend që të votojnë vetë për çështje të ndryshme. Përgjithësisht demokracia funksionon në këtë mënyrë në shumicën e vendeve (edhe në Shqipëri).

Në demokracinë e drejtpërdrejtë njerëzit votojnë vetë për çështje të ndryshme. Për shembull, më 23 qershor 2016, qytetarët e Mbretërisë së Bashkuar votuan për t'u larguar nga Bashkimi Evropian në referendumin e ashtuquajtur “Brexit”. Ky është një shembull i demokracisë së drejtpërdrejtë. Votimi në referendum u nda 51.9 % për t'u larguar dhe 48.1 % për të qëndruar, dhe në këtë mënyrë fushata për largimin nga BE-ja e fitoi votimin. Disa vende, si Zvicra, shpesh zhvillojnë referendume. Në vende të tjera, si Gjermania, është e ndaluar të ketë referendume kombëtare dhe ato zhvillohen vetëm në nivel vendor.

2

SI MUND TA DALLOJMË NËSE NJË VEND ËSHTË DEMOKRATIK?

Ekzistojnë lloje të ndryshme demokracish, por ato kanë tipare të përbashkëta. Të gjitha këto tipare ndihmojnë për të siguruar që njerëzit të mbajnë qeverinë nën kontroll.

1. ZGJEDHJE TË LIRA DHE TË DREJTA

Në demokraci, njerëzit kanë të drejtën e fjalës për mënyrën se si drejtohet vendi dhe ata e ushtrojnë këtë të drejtë nëpërmjet votës për të zgjedhur liderët e tyre politikë. Njerëzit mund të zgjedhin midis kandidatëve dhe partive politike të ndryshme, secila me ide dhe plane të ndryshme mbi mënyrën se si do ta drejtonin vendin nëse do të fitonin zgjedhjet.

Votuesit duhet të vendosin nëse u besojnë politikanëve në mbajtjen e premtimeve të tyre nëse fitojnë zgjedhjet. Por, nëse ata nuk i mbajnë premtimet, votuesit herën tjetër mund të zgjedhin të votojnë për dikë tjetër. Prandaj, zgjedhjet janë

një mjet i rëndësishëm që njerëzit të mbajnë qeveritë dhe politikanët nën llogaridhënie.

Mosha e votimit në shumicën e vendeve është 18 vjeç. Disa vende lejojnë edhe më të rinjtë të votojnë (për shembull 16 vjeç në Austri dhe Maltë, dhe 17 vjeç në Greqi), ndërsa disa vende të tjera e kanë më të lartë moshën e votimit.

Disa vende të botës kanë një ligj që parashikon “votimin e detyrueshëm”. Ky është rasti për shembull në Belgjikë dhe Luksemburg. Disa njerëz mendojnë se pjesëmarrja në zgjedhje është një detyrë qytetare dhe se qeveria është më legjitime kur një numër më i madh njerëzish marrin pjesë në zgjedhje. Disa vende madje vendosin sanksione ndaj atyre që nuk votojnë. Të tjerë thonë se votimi është më shumë një e drejtë sesa detyrë qytetare. Çfarë mendoni ju?

Çfarë janë zgjedhjet e lira dhe të drejta?

Zgjedhjet duhet të jenë “të lira”, gjë që do të thotë se secili duhet të jetë i lirë të votojë sipas zgjedhjes së tij. Zgjedhjet gjithashtu duhet të jenë “të drejta”, gjë që do të thotë se të gjithë votuesit duhet të kenë shanse të barabarta për t’u regjistruar për të votuar, të gjitha partitë politike duhet të kenë një shans të barabartë për të bërë fushatë për vota dhe të gjitha votat duhet të numërohen.



2. TË DREJTAT E NJERIUT DHE BARAZIA

Të drejtat e njeriut dhe demokracia janë të ndërlidhura dhe ne do të diskutojmë mbi të drejtat e njeriut dhe çfarë janë ato në një tjetër fletë informuese. Me fjalë të thjeshta, ne të gjithë kemi të drejta, sepse jemi qenie njerëzore. Këto të drejta nuk mund të na hiqen sepse ato janë pjesë e secilit prej nesh që kur kemi lindur. Të drejtat e njeriut zbatohen pavarësisht se nga jemi, në çfarë besojmë dhe si zgjedhim të jetojmë jetën tonë.

Ka disa të drejta themelore, të cilat janë veçanërisht relevante për demokracinë. Pa këto të drejta është shumë e vështirë që të bëjmë që zëri ynë të dëgjohet dhe të marrim pjesë në biseda mbi mënyrën se si drejtohet vendi. Këto përfshijnë, për shembull, të drejtën për të votuar dhe për të qenë kandidat në zgjedhje, lirinë e mendimit (të mendosh lirisht), lirinë e shprehjes (të flasësh lirisht) dhe lirinë e tubimit (për të organizuar dhe marrë pjesë në takime paqësore).

Çfarë është rregulli i shumicës?

Me fjalë të thjeshta, “rregulli i shumicës” garanton që një vendim merret nëse ai mbështetet nga një shumicë (më shumë se gjysma) e votave. Megjithatë, qeveria duhet të mbrojtë edhe të drejtat e pakicave dhe prandaj është e rëndësishme që të ketë mbrojtje të të drejtave të njeriut për të gjithë.

3. PJESËMARRJA

Përtej pjesëmarrjes në zgjedhje, njerëzit duhet të marrin pjesë edhe në jetën politike dhe kulturore të vendit të tyre në mënyra të tjera. Aktivitete të tilla si: organizimet dhe fushatat ndërgjegjësuese për ndërtimin e hyrjeve të përshtatshme për karriget me rrota për invalidët në ndërtesat e bashkisë ose në teatër, ose fushatat kundër prishjes së një parku, u ofrojnë individëve një mundësi për të ndikuar mbi vendimet publike. Të drejtat e njeriut, si liria për krijimin e shoqatave dhe e drejta për të marrë pjesë në jetën kulturore të komunitetit janë veçanërisht të rëndësishme për pjesëmarrjen.



4. SHETI I SË DREJTËS

Shteti i së Drejtës dhe demokracia janë të ndërlidhura dhe ne do të diskutojmë mbi Shtetin e së Drejtës dhe çfarë do të thotë ai në një tjetër fletë informuese. Me fjalë të thjeshta, Shteti i së Drejtës ka të bëjë me mënyrën se si përdoret pushteti politik. Do të thotë se njerëzit që kanë pushtetin për të vendosur rregullat duhet të ndjekin edhe vetë disa rregulla. Pra, rregullat duhet të bëhen në mënyrë të drejtë dhe të hapur. Zhvillimi i diskutimeve në lidhje me rregullat është pjesë e të jetuarit në demokraci dhe opinionet e ndryshme duhet të dëgjohen. Qeveria dhe organet e tjera publike duhet të përdorin kompetencat e tyre vetëm në mënyrë të drejtë dhe brenda kufijve të përcaktuar nga rregullat.

Rëndësi ka që rregullat të zbatohen në të njëjtën mënyrë për të gjithë, megjithatë, mund të ndodhë që njerëzit të trajtohen ndryshe, nëse ka një arsye reale dhe të rëndësishme për ta bërë këtë (për shembull, ka rregulla të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve). Nëse njerëzit mendojnë se rregullat nuk zbatohen në mënyrë të barabartë ose në mënyrën e duhur, për shembull, sepse ato shkelin të drejtat e njeriut, atëherë ata duhet t'u drejtohen gjykatave të pavarura që të kontrollojnë qeverinë.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme që të gjitha hallkat e shtetit (parlamenti, qeveria dhe gjykatat) të punojnë të pavarur nga njëri-tjetri dhe të kontrollojnë njëri-tjetrin. Kjo quhet “ndarja e kompetencave”.

Ndarja e Kompetencave:

Parlamenti (legjislativi) miraton ligjet e një vendi dhe njerëzit votojnë për të zgjedhur anëtarët e parlamentit, të cilët do të debatojnë për këto ligje dhe përfaqësojnë interesat e votuesve.

Qeveria (ekzekutivi) përcakton politikat dhe prioritetet e një vendi dhe i vendos ligjet në praktikë.

Gjykatat (gjyqësori) interpretojnë dhe zbatojnë ligjin dhe ofrojnë akses në drejtësi.

Ndarja e kompetencave kërkon që këto tre degë të shtetit (parlamenti, qeveria dhe gjykatat) të funksionojnë të ndara nga njëra-tjetra. Kjo mbron liritë e qytetarëve dhe u mundëson institucioneve të veçanta të kenë një sistem “kontrolli dhe balance” ndaj njëri - tjetrit në përdorimin e pushtetit.

3

PO PJESËMARRJA E FËMIJËVE?

Mbi 30 vjet më parë, në vitin 1989, udhëheqësit në shtete të botës miratuan Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, e cila është një marrëveshje ndërkombëtare për fëmijët. Fëmijët kanë të njëjtat të drejta të përgjithshme të njeriut si gjithë të tjerët, por kanë edhe disa të drejta të veçanta, sepse janë fëmijë.

Me fjalë të thjeshta, Konventa parashikon se “Fëmijët kanë të drejtë të shprehin lirisht mendimet e tyre për çështjet që i prekin ata” dhe se “Të rriturit duhet t'i dëgjojnë dhe t'i marrin seriozisht fëmijët”. (Burimi: “KDFOKB: Versioni për Fëmijë” nga UNICEF-i dhe Child Rights Connect.)

UNICEF thotë se “Pikëpamjet e fëmijëve duhet të dëgjohen dhe të merren parasysh në procesin politik - Fëmijët në përgjithësi nuk votojnë dhe tradicionalisht nuk marrin pjesë në proceset politike. Duke mos i kushtuar vëmendje të veçantë opinionëve të fëmijëve – siç shprehen në shtëpi dhe në shkollë, në komunitetet lokale dhe madje edhe në qeveri – nuk dëgjohen pikëpamjet e fëmijëve në lidhje me shumë çështje të rëndësishme që i prekin ata aktualisht ose do t'i prekin ata në të ardhmen.” Të drejtat e fëmijëve do t'i diskutojmë më me hollësi në një tjetër fletë informuese.

4

PSE ËSHTË E RËNDËSISHME DEMOKRACIA NË BASHKIMIN EVROPIAN?

DEMOKRACIA NË BASHKIM EVROPIAN

Demokracia është një nga vlerat kryesore të Bashkimit Evropian (BE). Një vend nuk mund të anëtarësohet në BE, nëse nuk është demokratik dhe nuk i lejon njerëzit e tij të ushtrojnë të drejtat e tyre demokratike.

Aktualisht BE-ja ka 27 vende anëtare. Vendet e tjera evropiane që plotësojnë kushtet për anëtarësim mund të aplikojnë për t'u bere pjese e BE-së. Këto kushte quhen “Kriteret e Kopenhagenit” dhe përfshijnë institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, Shtetin e së Drejtës, të drejtat e njeriut dhe respektimin dhe mbrojtjen e pakicave. Ato përfshijnë gjithashtu një ekonomi tregu të lirë dhe pranimin e të gjitha ligjeve të BE-së, duke përfshirë Euron.

1. PARLAMENTI EVROPIAN

Qytetarët e BE-së kanë të drejtë të votojnë dhe të kandidojnë në zgjedhjet e Parlamentit Evropian. Që nga viti 1979, zgjedhjet e Parlamentit Evropian mbahen çdo pesë vjet. Shtetasit e BE-së mund të votojnë për Anëtarët e Parlamentit Evropian (“eurodeputetët”), që të përfaqësojnë pikëpamjet e tyre në Evropë. Zgjedhjet e Parlamentit Evropian zhvillohen në çdo Shtet Anëtar të BE-së, kështu që nuk është e nevojshme të udhëtoni në Strasburg (Francë) ku ndodhet “selia” zyrtare e Parlamentit Evropian.

Në zgjedhjet e vitit 2019, shtetasit e BE-së zgjodhën 751 eurodeputetë, me mbi 250 milionë vota në Evropë. Zgjedhjet e ardhshme evropiane do të jenë në vitin 2024.

Mbretëria e Bashkuar u largua nga BE-ja më 31 janar 2020 dhe tani Parlamentin Evropian ka 705 vende ose deputetë, krahasuar me 751 përpara tërheqjes së Mbretërisë së Bashkuar. Për shpërndarjen e vendeve në Parlamentin Evropian mbahet në konsideratë numri i popullsisë së shteteve anëtare. Pra, mes vendeve anëtare të BE-së, Gjermania ka popullsinë më të madhe dhe

numrin më të madh të vendeve, ndërsa Malta, Luksemburgu dhe Qiproja kanë numrin më të vogël të popullsisë dhe numrin më të ulët të deputetëve të Parlamentit Evropian.

Sa vjeç duhet të jem për të votuar në zgjedhjet e Parlamentit Evropian?

Çdo vend përcakton moshën e votimit për zgjedhjet evropiane. Në shumicën e vendeve, ju duhet të keni mbushur 18 vjeç për të votuar në zgjedhjet evropiane. Sidoqoftë, në Greqi moshë e votimit është 17 vjeç, dhe 16 vjeç në Austri dhe Maltë.

2. INSTITUCIONET E TJERA TË BE-SË

Kur votoni në zgjedhjet e brendshme të vendit tuaj për të zgjedhur qeverinë e vendit, ju ndikoni se si do të përfaqësohen pikëpamjet tuaja në BE. Për shembull, kryeministrat dhe presidentët e vendeve anëtare të BE-së formojnë Këshillin Evropian, i cili përcakton prioritetet kryesore të BE-së. Ndërsa ministrat e qeverive të vendeve anëtare të BE-së janë pjesë e Këshillit të Bashkimit Evropian, i cili diskuton çështjet e BE-së dhe merr vendime në lidhje me legjislacionin dhe politikën e BE-së. Një mënyrë tjetër për të pasur ndikim si qytetar i BE-së është pjesëmarrja në konsultime publike. Komisioni i BE-së, i cili propozon ligje të reja për BE-në, kërkon mendime nga parlamentet kombëtare, qeveritë, qytetarët dhe palët e tjera të interesuara.

3. NISMA QYTETARE EVROPIANE

Nisma Qytetare Evropiane u mundëson njerëzve që të kenë ndikim më të madh për çështjet që kanë rëndësi për ta, duke i bërë thirrje Komisionit Evropian të propozojë ligje të reja. Ju duhet të merrni mbështetje për nismën tuaj duke mbledhur jo më pak se 1 milion firma të qytetarëve të paktën 7 vende në gjithë BE-në. Në vijim, nisma juaj do të shqyrtohet dhe Komisioni do të vendosë se çfarë veprimi do të ndërmerret.

4. PETICIONET DHE ANKESAT

Parlamentit Evropian mund t'i dërgohet një petition për të trajtuar një nevojë personale ose për të ngritur një çështje që është me rëndësi për shumë njerëz. Për më tepër, ankesat mund t'i dërgohen Avokatit të Popullit (Ombudsman-it) Evropian, nëse një institucion i BE-së vepron në shkelje të kompetencave dhe të ligjit.

5. KONFERENCA PËR TË ARDHMEN E EVROPËS

Konferenca për të Ardhmen e Evropës u mundëson qytetarëve evropianë të debatojnë se çfarë të ardhme duan për BE-në. Kjo ofron një shembull se si funksionon pjesëmarrja në nivelin e BE-së. Parlamenti Evropian, Këshilli dhe Komisioni Evropian janë zotuar bashkërisht të dëgjojnë dhe të marrin masa në vijim. Qytetarët evropianë nga e gjithë BE-ja mund të marrin pjesë në të duke shprehur ide dhe duke i diskutuar ato, duke marrë pjesë në aktivitete ose duke organizuar vetë një aktivitet.



TEMA 6: CILAT JANË TË DREJTAT E MIA SI FËMIJË?

1

ÇFARË JANË TË DREJTAT E FËMIJËVE?

Të drejtat e fëmijëve janë një nga llojet e të drejtave të njeriut. Ne do të diskutojmë për të drejtat e njeriut dhe çfarë janë ato në një tjetër fletë informuese. Me fjalë të thjeshta, ne të gjithë kemi të drejta sepse jemi qenie njerëzore. Këto të drejta nuk mund të na hiqen, sepse ato janë pjesë e secilit prej nesh që kur kemi lindur.

Fëmijët kanë të njëjtat të drejta, ashtu si të rriturit, si: të drejtën për ushqim, veshmbathje, strehim dhe kujdes mjekësor, të drejtën për të ndjekur shkollën falas, të drejtën për pushim dhe lodhje, dhe lirinë e fesë dhe besimit.

Fëmijët gjithashtu kanë të drejta të veçanta që lidhen me nevojat e tyre të posaçme si fëmijë. Të drejtat e fëmijëve vlejnë për të gjithë fëmijët dhe synojnë të sigurojnë që fëmijët të kujdesen dhe mbrohen siç duhet, që ata të mund të luajnë dhe të shkojnë në shkollë dhe të jenë të lumtur, të shëndetshëm dhe të sigurt. Për shembull, të drejtat e fëmijëve përfshijnë të drejtën për t'u dëgjuar, të drejtën për të mos u shfrytëzuar për punë dhe të drejtën për të qenë të sigurt ndaj të gjitha llojeve të dëmtimeve, kudo që të ndodhen, goftë edhe në internet apo në celular.



FAKTE PËRMBLEDHËSE

- Rreth një në tre njerëz në botë janë fëmijë (30.3%).
- Në vitin 1978, Polonia propozoi që të kishte një marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe përgatiti një projekt-konventë.
- Pas shumë pune dhe shumë negociatave, udhëheqësit botërorë miratuan përfundimisht Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) në vitin 1989.
- KDF-ja ka 54 paragrafë (të quajtur "Nene") për të drejtat e fëmijëve dhe mënyrën se si ata duhet të mbrohen.
- 196 vende kanë nënshkruar KDF-në dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë i vetmi vend që ende nuk është anëtarësuar zyrtarisht në KDF.
- Bazuar në KDF, qeveritë në mbarë botën kanë miratuar ligje të reja për të siguruar respektimin e të drejtave të fëmijëve.
- UNICEF-i (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët) është një strukturë e posaçme e sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe i dedikohet shpëtimit të jetëve të fëmijëve, mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe ndihmës për të realizuar potencialin e tyre.
- Dita Botërore të Fëmijëve festohet në 20 nëntor të çdo viti.

2

PSE JANË TË RËNDËSISHME TË DREJTAT E FËMIJËVE?

Të drejtat e fëmijëve janë të drejta të veçanta që njohin nevojat e posaçme të fëmijëve. Ato janë të rëndësishme sepse fëmijët mbështeten tek të rriturit për kujdes, mbrojtje, mbështetje dhe udhëzim, ndërkohë që ata rriten. Ajo që ndodh gjatë fëmijërisë mund të ndikojë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve, dhe kontributin e tyre të ardhshëm në shoqëri. Pra, është e rëndësishme që fëmijët të kenë të drejta ndërsa rriten, në mënyrë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë.

Fatkeqësisht, në mbarë botën, shumë fëmijë nuk i ushtrojnë të gjitha të drejtat e tyre. Kjo nuk do të thotë se ata fëmijë nuk vlerësohen, se të drejtat e fëmijëve nuk janë të rëndësishme, se pikëpamjet e fëmijëve nuk kanë rëndësi, as që marrëveshjet si Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës nuk janë të dobishme. Është e rëndësishme që ne të gjithë të punojmë së bashku për ta bërë botën një vend më të mirë për të gjithë fëmijët.



FAKTE PËRMbledhëse

- UNICEF-i vlerëson se ka 356 milionë fëmijë në mbarë botën që jetojnë në varfëri ekstreme.
- Brenda Bashkimit Evropian (BE), është vlerësuar se në vitin 2019, një në çdo pesë fëmijë (22.5%) ishte në rrezik varfërie ose përjashtimi social.
- UNICEF-i dhe Organizata Ndërkombëtare e Punës vlerësojnë se ka rreth 160 milionë fëmijë që bëjnë punë të detyruar në mbarë botën (që është afërsisht ekuivalenti i popullsisë së Mbretërisë së Bashkuar, Spanjës, Polonisë dhe Hungarisë së bashku!) dhe pothuajse gjysma e tyre janë të përfshirë në punë të rrezikshme për shëndetin fizik dhe mendor.
- OKB-ja vlerëson se çdo vit 12 milionë vajza martohen para moshës 18 vjeç. Në vendet më pak të zhvilluara 40% e vajzave martohen para moshës 18 vjeç.
- Banka Botërore thotë se të paktën gjysma e rreth 65 milionë fëmijëve të moshës të shkollës fillore dhe të mesme me aftësi të kufizuara nuk shkojnë në shkollë. Ajo gjithashtu vlerëson se një në tre fëmijë të moshës së shkollës fillore me aftësi të kufizuara nuk shkon në shkollë.
- Agjencia e BE-së për të Drejtat Themelore vlerëson se 2.5 milionë fëmijë u nënshtrohen procedurave ligjore çdo vit.

3

ÇFARË ËSHTË KONVENTA E KOMBEVE TË BASHKUARA PËR TË DREJTAT E FËMIJËS?

Mbi 30 vjet më parë, në vitin 1989, udhëheqësit botërorë miratuan Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (KDF). KDF-ja është një marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe këtë marrëveshje e kanë nënshkruar 196 vende.

Qeveria e çdo vendi është përgjegjëse për t'u siguruar që të drejtat e parashikuara në KDF të realizohen në praktikë, sepse kjo është një marrëveshje midis shteteve. Në praktikë, prindërit ose kujdestarët e fëmijëve, familjet, mësuesit dhe komunitetet më të gjera kanë gjithashtu një rol për të siguruar që të gjithë fëmijët të gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre. Për shembull, mësuesit duhet të ndërmarrin veprime nëse ka bullizëm në shkollë, sepse të gjithë fëmijët kanë të drejtë për një mjedis të sigurt mësimi. Një shembull tjetër është se, ndërsa prindërit kanë përgjegjësinë kryesore për rritjen e fëmijëve të tyre, qeveritë duhet t'i mbështesin prindërit nëse kanë nevojë për ndihmë, duke ofruar mbështetje financiare ose ndihmë në lidhje me strehimin.

KDF-ja shpjegon se fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç dhe se të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat e përmendura në Konventë. Të gjitha të drejtat e parashikuara në Konventë janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe njëlloj të rëndësishme. Janë katër të drejta në KDF që luajnë një rol veçanërisht të rëndësishëm për të ndihmuar në realizimin e të gjitha të drejtave të Konventës për të gjithë fëmijët. Ato njihen si “Parimet e Përgjithshme” dhe janë:

1) MOS-DISKRIMINIMI

Të drejtat e njeriut duhet të aplikohen pavarësisht se nga jemi, në çfarë besojmë dhe si zgjedhim të jetojmë jetën tonë. KDF-ja shpjegon se është veçanërisht e rëndësishme që çdo fëmijë të gëzojë të drejtat e Konventës pa diskriminim, “cilado qoftë përkatësia etnike, gjinia, feja, gjuha, aftësitë apo çdo status tjetër, çfarëdo që ata të mendojnë apo

thonë, pavarësisht prejardhjes së tyre familjare”. (Burimi: përmbledhja e KDF-së nga UNICEF-i)

2) INTERESAT MË TË LARTA TË FËMIJËS

Gjithashtu, KDF-ja përcakton se të rriturit dhe qeveritë duhet të veprojnë në bazë të “interesit më të lartë të fëmijës” kur marrin vendime që prekin fëmijët, për shembull, për arsimimin, shëndetin ose kujdesin e tyre.

Si vendosin të rriturit se çfarë është në interesin më të lartë të një fëmije? Ata duhet të shikojnë rrethanat e posaçme të fëmijës, duke përfshirë, për shembull, pikëpamjet e fëmijës, identitetin e fëmijës, duke përfshirë atë kulturor dhe fetar, situatën e tyre familjare, mbrojtjen, kujdesin dhe sigurinë e tyre si edhe të drejtat për kujdes shëndetësor dhe arsim. Gjithçka ka të bëjë me garantimin që fëmija të gëzojë të gjitha të drejtat e tij të parashikuara në KDF. Për shembull, ka disa raste kur familjet nuk mund të kujdesen për fëmijët e tyre dhe qeveria duhet t'u japë atyre mbrojtje dhe ndihmë të veçantë, dhe një nga mundësitë është vendosja e tyre në një shtëpi fëmijësh ose në një familje kujdestare, nëse vlerësohet se kjo do të jetë në “interesin më të lartë të tyre”.

3) E DREJTA PËR TË JETUAR, PËR TË MBIJETUAR DHE PËR T'U ZHVILLUAR

KDF-ja shpjegon se të gjithë fëmijët kanë të drejtë për të jetuar dhe se qeveritë duhet të bëjnë gjithçka që munden për të siguruar që fëmijët të mbijetojnë dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Për shembull, KDF-ja shpjegon se fëmijët kanë të drejtë për kujdes të mirë shëndetësor, ushqim të shëndetshëm, ujë të pijshëm dhe të pastër, si dhe një vend të pastër e të sigurt për të jetuar.

KDF-ja shpjegon gjithashtu se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të shkojnë në shkollë, të mësojnë dhe të luajnë në mënyrë që të zhvillohen dhe të rriten. Ka edhe disa aktivitete që nuk janë të përshtatshme për zhvillimin e fëmijëve. Për shembull, KDF-ja shpjegon se fëmijët nuk duhet të shfrytëzohen për punë dhe duhet të mbrohen nga puna që dëmton shëndetin e tyre mendor ose fizik, ose edukimin e tyre.

4) E DREJTA PËR T'U DËGJUAR

Së fundmi, KDF-ja shpjegon gjithashtu se fëmijët kanë të drejtë të shprehin lirisht pikëpamjet e tyre për çështjet që i prekin dhe ata duhet të merren seriozisht. Kjo nuk do të thotë që fëmijët duhet të vendosin për gjithçka vetë pa u ndihmuar nga të rriturit. Por, ndërsa fëmijët rriten dhe bëhen më të pjekur dhe më të aftë për të marrë vendime, pikëpamjet e tyre do të mbartin më shumë peshë.

Si dëgjohen pikëpamjet e fëmijëve?
Pikëpamjet e fëmijëve duhet të dëgjohen dhe të merren seriozisht për të gjitha çështjet që i prekin. Për shembull, në arsim, mund të ketë një këshill shkollë ku nxënësit mund të japin mendimet e tyre për jetën dhe punën e shkollës. Ata mund të flasin për rregullat e shkollës, cilësinë e ushqimit të ofruar në mensën e shkollës, muzikën dhe aktivitetet sportive pas shkollës, se si shkolla mund të mbrojë më mirë mjedisin ose cilat libra duhet të blihen për bibliotekën e shkollës.

Për të dhënë një shembull tjetër, në komunitetet lokale (për shembull bashki ose fshat), mund të krijohet një mini-parlament i të rinjve ose të zhvillohen vizita në shkolla nga drejtuesit e komunitetit lokal, ku fëmijët mund të japin mendimet e tyre për bibliotekat, parqet, qendrat e kohës së lirë, kujdesin shëndetësor, transportin ose çështje të tjera të komunitetit. Këto aktivitete janë të vlefshme sepse qeveritë marrin vendime dhe bëjnë plane për shumë çështje që ndikojnë në jetën e fëmijëve - nga arsimi dhe kujdesi për fëmijët, te ushqimi, strehimi, siguria rrugore, kujdesi shëndetësor, aktivitetet kulturore dhe fetare.

Prandaj, KDF-ja ofron një mbështetje të fortë për të drejtat e fëmijëve dhe u jep fëmijëve një zë në sferat ku ata më parë nuk ishin dëgjuar.

Ç'është shumë e rëndësishme, KDF-ja dhe dokumentet e lidhura me të (të quajtura "Protokolle") iu lejojnë fëmijëve të bëjnë ankesë në OKB, nëse të drejtat e tyre janë shkelur dhe nuk u është ofruar një shqyrtim gjyqësor në gjykatat e vendit të tyre.



4

SI MBROHEN TË DREJTAT E FËMIJËVE
NË BASHKIMIN EVROPIAN?

Të drejtat e fëmijëve mbrohen edhe në Bashkimin Evropian (BE) dhe ky është një nga synimet kryesore të BE-së. Neni 3(3) i Traktatit të Bashkimit Evropian parashikon se BE-ja “lufton përjashtimin dhe diskriminimin social dhe promovon drejtësinë dhe mbrojtjen sociale, barazinë midis grave dhe burrave, solidaritetin midis brezave dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

Karta e BE-së për të Drejtat Themelore përmban të drejtat themelore të secilit brenda BE-së dhe disa Nene të Kartës u dedikohen posaçërisht fëmijëve. Për shembull, Neni 24 ka të bëjë me të drejtat e fëmijës dhe Neni 32 ndalon punën e fëmijëve.

Brenda Komisionit të BE-së, i cili është një nga organet kryesore qeverisëse të BE-së, ekziston një **Koordinator për të drejtat e fëmijës** që nga viti 2007, për t’u siguruar që të gjitha departamentet e Komisionit të marrin parasysh siç duhet të drejtat e fëmijëve në të gjitha politikat dhe aktivitetet.

Me kontributin e më shumë se 10,000 fëmijëve, BE-ja ka zhvilluar një strategji dhe plan veprimi të rëndësishëm që lidhet me fëmijët, të quajtur **“Strategjia për të Drejtat e Fëmijës”**.

Strategjia është hartuar për fëmijët dhe përfshin rreth gjashtë fusha tematike:

1. “Pjesëmarrja në jetën politike dhe demokratike: Një BE që fuqizon fëmijët të jenë qytetarë dhe anëtarë aktivë të shoqërive demokratike”.
2. “Përfshirja socio-ekonomike, shëndetësia dhe arsimi: Një BE që lufton varfërinë e fëmijëve, promovon shoqëritë gjithëpërfshirëse dhe miqësore për fëmijët, sistemet shëndetësore dhe arsimore”.
3. “Lufta kundër dhunës ndaj fëmijëve dhe sigurimi i mbrojtjes së fëmijëve: Një BE që i ndihmon fëmijët të rriten pa dhunë”.
4. “Drejtësia miqësore për fëmijët: Një BE ku sistemi i drejtësisë mbështet të drejtat dhe nevojat e fëmijëve”.
5. “Shoqëria digjiitale dhe e informacionit: Një BE ku fëmijët mund të lundrojnë të sigurt në mjedisin digjital dhe të shfrytëzojnë mundësitë e tij”.
6. “Dimensioni Global: Një BE që mbështet, mbron dhe fuqizon fëmijët në nivel global, edhe në periudha krize dhe konflikti”.

(Burimi: Strategjia e BE-së për të Drejtat e Fëmijëve.)



TEMA 7: ÇFARË PO BËN BE-JA PËR MIGRACIONIN?

1 KUSH QUHET MIGRANT?

Migranti është një person që largohet nga shtëpia e tij ose e saj drejt një vendi tjetër dhe kalon atë që ne e quajmë “**kufi shtetëror**” (p.sh., nga Franca në Gjermani) ose kalon shumë kufij shtetërorë. Ky njihet si “**migrim**”. Njerëzit gjithashtu mund të lëvizin **brenda vendit të tyre** dhe, nëse janë detyruar të lëvizin për shkak të një lufte ose konflikti, ose për shkak të një fatkeqësie natyrore (p.sh., një tërmet ose një përmbytje), ata njihen si “**persona të zhvendosur brenda vendit**”.

Në shumicën e rasteve, migrantët largohen nga vendi i tyre për të kërkuar një jetë më të mirë diku tjetër, kryesisht për të punuar, për të studiuar ose për t'u bashkuar me familjen e tyre jashtë vendit. Ndonëse të gjithë kanë të drejtën të largohen nga vendi i tyre i origjinës, nuk ekziston një e drejtë e barazvlefshme për hyrjen në një shtet tjetër. Migrantët zakonisht kanë nevojë për vizë dhe leje

pune, studimi ose qëndrimi, dhe zakonisht nuk e kanë të drejtën për të qëndruar në shtetin e zgjedhur prej tyre për një kohë të pakufizuar.

Ka lloje të ndryshme migrantësh: **punëtorët migrantë** i kalojnë kufijtë për të gjetur punë; **studentët ndërkombëtarë** migrojnë në një shtet tjetër për të ndjekur shkollën ose për të studiuar në universitet; **migrantët e parregullt** janë personat që nuk mund të qëndrojnë më në një vend të huaj, sepse, për shembull, viza e hyrjes ose leja e qëndrimit u ka skaduar. **Migrantët e trafikuar** janë njerëz që sillen në një vend tjetër me qëllim shfrytëzimi (për shembull, puna e detyruar).

Në shumicën e rasteve, migrantët janë të lirë të kthehen në vendin e tyre të origjinës në çdo kohë, nëse gjërat nuk funksionojnë siç kishin shpresuar.



FAKTE PËRMBLEDHËSE: MIGRIMI NË SHIFRA

- “Raporti Botëror i Migracionit 2022” i publikuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin vlerëson se në vitin 2020 kishte 281 milionë migrantë ndërkombëtarë në mbarë botën, pra 3.6% e popullsisë globale. Në vitin 2019 kishte 169 milionë punëtorë migrantë (njerëz që janë shpërngulur për punë).
- Raporti vlerëson gjithashtu se, bashkërisht, Europa dhe Azia priten rreth 61% të migrantëve ndërkombëtarë në vitin 2020.

2

CILI ËSHTË DALLIMI MIDIS NJË MIGRANTI, NJË AZIL-KËRKUESI DHE NJË REFUGJATI?

Refugjatët dhe azil-kërkuesit janë pjesë e një kategorie të veçantë migrantësh.

Kërkimi i azilit është një e drejtë e njeriut – kushdo, ikën nga një persekutim, ka të drejtë të kërkojë dhe të gëzojë azil (mbrojtje) në vende të tjera.

Një azil-kërkues (personi që kërkon azil) është dikush, kërkesa e të cilit për azil (mbrojtje) në një vend tjetër nuk ka marrë ende një përgjigje. Kërkesa për azil mund të rezultojë në njohjen e statusit të refugjatit të personit.

Refugjatët zakonisht i ikin luftës, konfliktit ose persekutimit dhe gëzojnë mbrojtjen e të drejtës ndërkombëtare. Një marrëveshje ndërkombëtare e quajtur **Konventa e Refugjatëve e vitit 1951** parashikon se refugjatët janë njerëz që janë jashtë vendit të tyre dhe nuk mund të përfitojnë nga mbrojtja e atij vendi për shkak të një frike të mirëbazuar nga persekutimi (si kërcënimi për jetën ose lirinë) për arsye racore, feje, kombësie, anëtarësie në një grup të caktuar shoqëror ose opinionin politik. Autoritetet e vendit të destinacionit

e hetojnë kërkesën e personit për azil. Nëse plotësohen kushtet për t'u konsideruar si "refugjat", ata e "njohin" personin si refugjat, dhe i japin statusin e refugjatit.

Arsyet e emigrimit të refugjatëve janë të drejtat e njeriut dhe siguria, jo përfitimi ekonomik. Disa refugjatë detyrohen të arratisen pa paralajmërim dhe shumë prej tyre kanë pasur përvoja të këqija ose janë keqtrajtuar. Udhëtimi drejt sigurisë është shpesh i rrezikshëm dhe shumë refugjatë rrezikojnë jetën e tyre në kërkim të mbrojtjes. Refugjatët nuk mund të kthehen në vendin e tyre nëse nuk përmirësohet gjendja që i ka detyruar të largohen.

Sic u përmend më lart, të drejtat e refugjatëve janë përcaktuar dhe mbrohen në Konventën e Refugjatëve të vitit 1951, e cila është pranuar nga 146 vende. Të drejtat e refugjatëve mbrohen gjithashtu nga **marrëveshjet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut** si Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, të cilat i kemi diskutuar në fletë të tjera informuese.



FAKTE PËRMBLEDHËSE: REFUGJATËT

- “Raporti Botëror i Migracionit 2022” i Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin vlerëson se në vitin 2020 kishte rreth 26.4 milionë refugjatë në botë.



3

SI I MBRON BE-JA MIGRANTËT?

Siç e theksuam më lart, ka kategori të ndryshme njerëzish që largohen nga vendi i tyre, me dëshirë apo jo, për të shkuar në një shtet tjetër. Niveli i të drejtave dhe mbrojtjes që u jepet atyre nga Bashkimi Evropian (BE) ndryshon ndërmjet kategorive të migrantëve si më poshtë.

Lista në vijim prezanton kategoritë e ndryshme të migrantëve, në rend zbritës, në lidhje me të drejtat dhe përfitimet e tyre.

1) Migrantët Shtetas të BE-së – Kemi diskutuar të drejtat e qytetarëve/shtetasve të BE-së në një tjetër fletë informuese, ku theksuam se ata kanë të drejtë të lëvizin lirshëm brenda BE-së dhe mund të vendosin të jetojnë në një shtet tjetër anëtar të BE-së. Për ta nuk është e nevojshme as viza, dhe as leja e qëndrimit apo e punës. Nëse një shtetas gjerman migron në Hungari për të punuar, ai ose ajo është një punëtor migrant që gëzon të drejta të veçanta si shtetas i BE-së.

2) Anëtarët e Familjeve të Shtetasve të BE-së që vijnë nga Vendet e Treta – Anëtarët e familjeve të shtetasve të BE-së gëzojnë gjithashtu të drejta të posaçme, edhe nëse nuk janë vetë shtetas të BE-së. Për shembull, një shtetas maroken ose kanadez gëzon të drejtën për t'u ribashkuar me bashkëshortin ose bashkëshorten, ose prindin e tij/saj, që është shtetas i BE-së, dhe, në kushte të caktuara, ka të drejtë të punojë në BE. Hyrja në BE zakonisht është e mundur në bazë të një vize për arsye familjare.

3) Azil-kërkuesit dhe Refugjatët – Përsa u përket azil-kërkuesve dhe refugjatëve, njerëzit që plotësojnë kërkesat e Konventës së Refugjatëve të vitit 1951 kanë të drejtën e mbrojtjes, azilit, në BE. Një kërkesë për azil mund të rezultojë në njohjen e “statusit të refugjatit” të personit (ose mund të rezultojë në “statusin e mbrojtjes plotësuese”, kur një person nuk kualifikohet si refugjat, por ende ka nevojë për mbrojtje ndërkombëtare).

CILI ËSHTË DALLIMI MIDIS NJË “REFUGJATI” DHE DIKUJT QË KUALIFIKOHET PËR STATUSIN “E MBROJTJES PLOTËSUESE”?

Siç u përmend më lart, Konventa e Refugjatëve e vitit 1951 parashikon se **refugjatët** janë njerëz që ndodhen jashtë shtetit të tyre dhe nuk mund të përfitojnë nga mbrojtja e atij shteti për shkak të një frike të mirëbazuar nga persekutimi (si kërcënimi për jetën ose lirinë) për shkak të përkatësisë racore, fetare, të kombësisë, ose anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror apo për arsye të opinionëve politike.

E drejta e BE-së përcakton kriteret e kualifikimit të njerëzve me statusin e

refugjatit ose statusin e mbrojtjes plotësuese.

Mbrojtja plotësuese mund të jepet kur një njeri nuk kualifikohet si refugjat, por kur besohet se personi, nëse kthehet në shtetin e tij, do të përballet me një rrezik real për të pësuar dëme serioze dhe personi nuk mund të përfitojë nga mbrojtja e atij shteti.

Mbrojtja plotësuese shihet si një formë më e kufizuar e mbrojtjes dhe, për shembull, mund të ketë rregulla të ndryshme për bashkimin familjar për personat me status të mbrojtjes plotësuese në krahasim me refugjatët.

Karta e BE-së për të Drejtat Themelore përmban të drejtat themelore të çdo personi brenda BE-së dhe disa paragrafë (Nene) të Kartës kanë të bëjnë në mënyrë specifike me këto çështje.

Për shembull, Neni 18 i Kartës ka të bëjë me të drejtën për azil. Neni 19 ka të bëjë me mbrojtjen e individëve nga largimi, dëbimi ose ekstradimi (dërgimi) në një vend ku ata personalisht do të ishin në rrezik serioz për dënim me vdekje ose keqtrajtim. Gjithashtu, kur shumë migrantë mbërrijnë me barka ose rrugë tokësore në një shtet, Neni 19 i Kartës i ndalon autoritetet e atij shteti që ti kthejnë të gjithë prapa (të njohur edhe si “dëbimet kolektive”) në kufijtë e BE-së dhe kërkon që kërkesa për azil e secilit person të merret parasysh individualisht.

4) Punëtorët Migrantë të Rregullt dhe Studentët

– Ata që nuk janë shtetas të BE-së (për shembull, shtetas amerikanë, sirianë, kinezë ose nigerianë) gjithashtu mund të shkojnë në një nga vendet

anëtare të BE-së për qëllime pune ose studimi, por më shumë se sa një e drejtë, ky është një vendim që merret nga autoritetet e çdo vendi anëtar të BE-së. Hyrja në BE zakonisht do të jetë e mundur në bazë të një vize pune ose studimi. Një leje pune ose studimi për një periudhë të caktuar kohore zakonisht jepet pasi të plotësohen disa kushte.

5) Migrantët e Parregullt – Ata që nuk janë shtetas të BE-së dhe gjenden në mënyrë të parregullt në territorin e një shteti të BE-së (për shembull, kanë hyrë jo ligjërisht ose viza/leja e qëndrimit u ka skaduar) gëzojnë më pak mbrojtje. Në përgjithësi, ata punojnë duke mos patur mbrojtjen e kontratës së punës (për shkak të statusit të tyre të parregullt) dhe janë të pambuluar nga sigurimet shoqërore. Nëse kapen nga policia, migrantët e parregullt zakonisht i nënshtrohen dëbimit në vendin e tyre të origjinës, përveç rasteve kur, në mënyrë të jashtëzakonshme, arsyet familjare, të sigurisë ose shëndetësore e justifikojnë qëndrimin e tyre në BE.



4

CILA ËSHTË POLITIKA E BE-SË PËR MIGRACIONIN?

Siç kemi diskutuar në një tjetër fletë informuese, 27 vendet anëtare të BE-së punojnë së bashku në nivel të BE-së për të zgjidhur çështjet që prekin të gjithë ata që jetojnë në BE. Ata përpiqen të kapërcejnë mosmarrëveshjet e tyre për të trajtuar së bashku sfidat e rëndësishme. Migracioni është një nga këto sfida.

Politika e BE-së për migracionin përqendrohet në dy aspekte. Së pari, BE-ja synon të forcojë kontrollet në kufijtë e jashtëm të BE-së, si në kufijtë detarë ashtu dhe tokësorë, duke arritur marrëveshje ose duke ofruar mbështetje për vendet fqinje jo-anëtare të BE-së, si për shembull Shqipëria, Libia, Maroku dhe Turqia.

Së dyti, BE-ja synon të zhvillojë një “sistem të përbashkët azili”. Çfarë do të thotë kjo? Vendet anëtare të BE-së kanë rënë dakord të kenë një politikë të përbashkët evropiane për azilin të quajtur “Sistemi i Përbashkët Evropian i Azilit (SPEA)”. Ky siguron që procedurat për dhënien e azilit dhe njohjen e statusit të refugjatit të jenë të drejta dhe efikase në të gjithë BE-në.

SPEA përfshin katër pjesë thelbësore të legjisllacionit të BE-së që mbulojnë aspekte të ndryshme të procesit të azilit:

CILI SHTET DUHET TA SHQYRTOJË KËRKESËN PËR AZIL?

“Rregullorja e Dublinit” përcakton se cili Shtet Anëtar është përgjegjës për shqyrtimin e një kërkesë për azil. Për shembull, nëse një azil-kërkues sirian arrin me barkë në Itali, por më pas udhëton për në Gjermani, Rregullorja e Dublinit përcakton se cili vend anëtar duhet të shqyrtojë kërkesën për azil.

KUSH ËSHTË REFUGJAT/E DHE CILAT JANË TË DREJTAT E TIJ/SAJ?

Direktiva e Kualifikimit përcakton se kush kualifikohet si “refugjat” dhe kush kualifikohet për statusin “mbrojtje plotësuese” dhe ofron një sërë të drejtash për përfituesit (lejet e qëndrimit, dokumentet e udhëtimit, aksesit në punësim dhe arsim, mirëqenie sociale, strehim dhe kujdes shëndetësor).

CILAT DUHET TË JENË STANDARDET E JETESËS PËR AZIL-KËRKUESIT?

Direktiva për Kushtet e Pritjes përcakton standardet e përbashkëta të jetesës dhe kushtet e pritjes për azil-kërkuesit. Ajo gjithashtu garanton që kërkuesit të kenë akses në strehim, ushqim, veshmbathje, arsimim ose punësim dhe kujdes shëndetësor.

CILAT JANË RREGULLAT PËR PROCEDURAT E AZILIT?

Direktiva për Procedurat e Azilit vendos standarde të përbashkëta për vendime dhe procedura të drejta dhe efikase për azilin.

5

ÇFARË ËSHTË KRIZA E MIGRANTËVE NË BE OSE KRIZA E REFUGJATËVE NË BE?

Ju mund të keni dëgjuar në lidhje me “krizën e migrantëve në BE” ose “krizën e refugjatëve të BE” (shpesh të dyja shprehjet përdoren - gabimisht - në mënyrë të ndërsjellë), por çfarë është kjo?

Këto terma përdoren shpesh për t’iu referuar vitit 2015, kur në vendet anëtare të BE-së u bënë më shumë se 1.2 milionë kërkesa për azil, që ishte më shumë se dyfishi i numrit në vitin 2014. Shumica e azil-kërkuesve i ishin shmangur luftës dhe konfliktit në Siri, Afganistan dhe Irak. Personat e tjerë që kërkonin azil erdhën, për shembull, nga Kosova, Shqipëria, Pakistani, Eritrea, Nigeria dhe Irani. Për më tepër, udhëtimi ishte shpesh jashtëzakonisht

i rrezikshëm dhe Organizata Ndërkombëtare për Migracionin vlerëson se më shumë se 3,770 njerëz vdiqën në vitin 2015 në përpjekje për të kaluar Detin Mesdhe për në Evropë.

Kohët e fundit, Parlamenti i BE-së raportoi se kufizimet e lëvizjes, mbylljet e kufijve dhe reduktimet e programeve për pranimin e refugjatëve, të cilat u vendosën gjatë pandemisë COVID-19, kanë rezultuar në ulje të migrimin. Gjithashtu, u vu në dukje se kërkesat për azil në dhjetë muajt e parë të vitit 2020 ishin 33% (një e treta) më e ulët se në të njëjtën periudhë të vitit 2019.

Lesbos, Greqi - 30 shtator 2015:
Refugjatët mbërrijnë me barka nga Turqia.



FAKTE PËRMBLEDHËSE: MIGRIMI NË EVROPË

- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) vlerëson se fëmijët përbëjnë një të tretën e refugjatëve dhe migrantëve që kanë mbërritur në Evropë.
- Gjithashtu, vlerësohet se çdo ditë, më shumë se një fëmijë vdes në rrugën e rrezikshme të Mesdheut Qendror në përpjekje për të udhëtuar nga Afrika e Veriut në Evropën Qendrore.
- Agjencia e OKB-së për Refugjatët (UNHCR) vlerëson se në fund të vitit 2020 kishte 26.4 milionë refugjatë në mbarë botën dhe 10% e tyre jetonin në BE.
- Krahasuar me numrin e përgjithëm të popullsisë, përqindja e refugjatëve të strehuar në BE është 0.6%.
- Për sa i përket kërkesave për azil në Evropë, vihet re se në vitin 2020, 141,000 azil-kërkues ishin nën moshën 18 vjeç, dhe gati 10% e tyre (13,500) ishin fëmijë të pashoqëruar (që vinin kryesisht nga Afganistani, Siria dhe Pakistani).




TEMA 8: ÇFARË ËSHTË NDRYSHIMI KLIMATIK DHE ÇFARË PO BËN BE-JA PËR KËTË?

1 ÇFARË ËSHTË NDRYSHIMI KLIMATIK?

“Ndryshimi klimatik përbën një ndryshim në rrethanat e zakonshme - të tilla si temperatura dhe reshjet - në një rajon për një periudhë të gjatë kohore. Shkencëtarët e NASA-s kanë vëzhguar se sipërfaqja e Tokës po ngrohet dhe shumë nga vitet më të ngrohta janë regjistruar në 20 vitet e fundit.”

(Burimi: Faqja e internetit e NASA-s Climate Kids “Çfarë është ndryshimi i klimës?”)



Kur flasim për motin, zakonisht u referohemi kushteve të jashtme. Parashikimet e motit na tregojnë se çfarë kushtesh moti mund të presim në ditët ose javët e ardhshme. Për shembull, ato na tregojnë nëse mund të jetë diell, shi, erë, borë, nxehtë apo ftohtë dhe, në këtë mënyrë mund të na ndihmojnë të vendosim se çfarë të veshim dhe nëse mund të kalojmë kohë jashtë.

Megjithatë, kur flasim për klimën, i referohemi kushteve tipike të motit që presim të kemi në një vend gjatë një viti. Për shembull, mund të përshkruajmë një vend të caktuar me pranverë të butë, verë të nxehtë, vjeshtë të lagësht dhe dimër të ftohtë e të thatë. Rajone të ndryshme në të njëjtin shtet, për shembull në thellësi të territorit ose në bregdet, mund të kenë klima të ndryshme. Zona të ndryshme të planetit, për shembull shkretëtira e Saharasë dhe Poli i Veriut, gjithashtu kanë klima shumë të ndryshme.

Ndryshimi i klimës është një ndryshim në ato rrethana të zakonshme që ekzistojnë për një kohë të gjatë. Klima e Tokës ka ndryshuar shumë herë gjatë historisë së saj dhe, në të kaluarën, kjo ndodhte për shkaqe natyrore.

Megjithatë, në rreth 150 vitet e fundit toka është ngrohur shumë më shpejt dhe tani po përballemi me një “krizë klimatike”. Edhe një ndryshim i vogël i temperaturës, një ose dy gradë Celsius, mund të ndikojë ndjeshëm në jetën tonë dhe shëndetin e planetit tonë. Shenja të tjera të ndryshimit të klimës përfshijnë ngrohjen e oqeanëve, tkurrjen e shtresave të akullit dhe akullit të detit, shkrirjen e akullnajave, ngritjen e nivelit të detit dhe ngjarje më ekstreme të motit (si valët e të nxehtit, thatësitat dhe përmbytjet).

2

ÇFARË E SHKAKTON NDRYSHIMIN KLIMATIK?

Shkencëtarët më në zë bien dakord se ndryshimet që po shikojmë tani në klimën e Tokës po ndodhin kryesisht për shkak të aktiviteteve njerëzore.

“Ndryshimet klimatike u referohen ndryshimeve afatgjata të temperaturave dhe të motit. Këto ndryshime mund të jenë të natyrshme, si për shembull ndryshimet në ciklin diellor. Por, që nga vitet 1800, aktivitetet njerëzore kanë qenë nxitësi kryesor i ndryshimeve klimatike, kryesisht për shkak të djegies së lëndëve djegëse fosile si qymyri, nafta dhe gazi.

Djegia e lëndëve djegëse fosile gjeneron çlirimin e gazeve serrë, që veprojnë si një batanije e vendosur rreth Tokës, duke bllokuar nxehtësinë e diellit dhe duke rritur temperaturat.

Shembuj të gazeve serrë që po shkaktojnë ndryshime klimatike përfshijnë dioksidin e karbonit dhe metanin. Këto vijnë, për shembull, nga përdorimi i benzinës për automjetet ose përdorimi i qymyrit për ngrohjen e një ndërtese. Zhveshja e tokës dhe pyjeve gjithashtu mund të çlirojnë dioksid karboni. Vendgrumbullimet e mbeturinave janë një burim kryesor i emetimit të metanit. Energjia, industria, transporti, ndërtesat, bujqësia dhe përdorimi i tokës janë ndër emetuesit kryesorë”.

(Burimi: Faqja e internetit e Kombeve të Bashkuara “Çfarë është ndryshimi i klimës?”)

Vijat ngrohëse të klimatologut Ed Hawkins: Ngjyrat nga bluja (më ftohtë) në të kuqe (më ngrohtë) tregojnë rritjen e temperaturës mesatare globale midis 1850 (në të majtë) dhe 2018 (në të djathtë)

PSE KA RËNDËSI NDRYSHIMI KLIMATIK

“Ndryshimet klimatike mund të ndikojnë në shëndetin tonë, aftësinë për të kultivuar ushqim, strehimin, sigurinë dhe punën.”

(Burimi: Faqja e internetit e Kombeve të Bashkuara “Çfarë është ndryshimi i klimës?”)

Ndryshimet klimatike kanë rëndësi, sepse disa rajone të botës mund të nxehen në mënyrë të rrezikshme (si Afrika Sub-Sahariane) dhe të tjera mund të bëhen të papërshtatshme për të jetuar për shkak të rritjes së nivelit të detit (siç janë shtetet e vogla ishullore). Në ditët tona shikojmë njerëz, të cilët zhvendosen për shkak të fatkeqësive që lidhen me motin ekstrem dhe ndryshimi i klimës mund ta përkeqësojë këtë.




FAKTE PËRMBLEDHËSE:

- Viti 2021 ishte një nga shtatë vitet më të ngrohta të regjistruara.
- Dekada e fundit 2011-2020 ishte më e nxehta e regjistruar.
- 28 trilion ton akull janë zhdukur nga sipërfaqja e Tokës që nga viti 1994.
- Deri në 1 milion specie shtazore dhe bimore rrezikojnë të zhduken.

“Shkaku kryesor i ndryshimeve klimatike është aktiviteti njerëzor dhe çlirimi i gazeve serrë.” (Burimi: Faqja e Internetit e Zyrës së Metereologjisë në Mbretërinë e Bashkuar “Shkaqet e ndryshimit të klimës”)

Aktivitetet njerëzore që prodhojnë emetime të gazeve serrë përfshijnë:



1. Djegia e lëndëve fosile (të tilla si: qymyri, nafta dhe gazi)

– Kur ato digjen, lëndët djegëse fosile lëshojnë gaze në atmosferë, veçanërisht dioksid karboni.



2. Shpyllëzimi (prerja e pemëve)

– Pemët mund të ndihmojnë klimën duke hequr dhe mbajtur dioksidin e karbonit nga atmosfera. Megjithatë, kur pemët priten (për shembull, për të krijuar hapësirë për ferma, qytete ose rrugë, për të prodhuar me to mobilie ose shtëpi, ose për t’u djegur për ngrohje dhe energji), ne e humbasim këtë efekt pozitiv dhe karboni i ruajtur në pemë çlirohet kur ato digjen.



3. Bujqësia

– Sasi të mëdha metani prodhohen gjatë tretjes së ushqimit nga lopët dhe delet. Oksidi i azotit prodhohet nga disa fertilizues që përmbajnë azot. (Fertilizuesit përdoren në bujqësi për të përmirësuar rritjen e të korrave dhe sasinë e të korrave të vjela).



3

ÇFARË MUND TË BËJMË PËR TË NDIHMUAR?

Një pyetje themelore është se si mund të vazhdojmë me aktivitete që janë të rëndësishme për jetën tonë (bujqësia, ndërtimi, përdorimi i transportit, prodhimi i energjisë etj.) duke ndihmuar në të njëjtën kohë edhe planetin?

Ja disa gjëra që mund të bëjmë:



Të ulim numrin e fluturimeve.



Të blejmë më pak gjëra dhe të blejmë artikuj vendas.



Të ecim ose të përdorim biçikletën në vend të makinës.
Të zgjedhim të lëvizim disa persona me një automjet ose të përdorim transportin publik.



Të riciklojmë, riparojmë dhe ripërdorim produkte dhe të preferojmë produkte të bëra nga materiale të ricikluara.



Të kursejmë energjinë duke fikur dritat dhe pajisjet e tjera kur është e mundur.



Të veshim një bluzë më të trashë në vend që të ndezim ngrohjen kur është ftohtë.



Të mbjellim më shumë pemë.



Të përdorim energji të rinovueshme si energjia diellore ose energjia e erës.



Të ndryshojmë çfarë hamë – të konsumojmë ushqimet me bazë bimore, të blejmë ushqime vendase dhe sezonale dhe të shmangim krijimin e mbeturinave të ushqimit.



T'i bashkohemi ose të themelojmë një eko-klub në shkollë për të gjetur mënyra për ta bërë shkollën më miqësore për mjedisin.



ÇFARË KUPTOHET ME “GJURMË KARBONI”?

“Gjurma e karbonit është sasia e dioksidit të karbonit të lëshuar në ajër për shkak të nevojave tuaja për energji. Ju keni nevojë për transport, energji elektrike, ushqim, veshje dhe mallra të tjera. Zgjedhjet tuaja mund të bëjnë ndryshimin.”

(Burimi: Faqja e internetit të NASA-s Climate Kids “Çfarë mund të bëjmë për të ndihmuar?”)

4

ÇFARË PO BËN BASHKIMI EVROPIAN PËR NDRYSHIMET KLIMATIKE?

LUFTA KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE ËSHTË E RËNDËSISHME PËR TË ARDHMEN E EVROPËS

“Për Evropën, një raport [i kohëve të fundit] parashikon një rritje në shpeshtësinë dhe intensitetin e ngjarjeve ekstreme të motit, duke përfshirë valët e të nxehtit detar, si dhe paralajmëron se një rritje prej 2°C në temperaturë do të ketë efekte kritike për natyrën dhe njerëzit.

Temperaturat më të larta dhe fenomenet e motit do të rezultojnë gjithashtu në kosto të mëdha për ekonominë e BE-së dhe do të pengojnë aftësinë e vendeve për të prodhuar ushqim.

Megjithatë, sipas shkencëtarëve, veprimet e ndërmarra nga njerëzit mund ta ndryshojë rrjedhën e ngjarjeve.”

(Burimi: Faqja e internetit e Këshillit Evropian/Këshillit të BE-së “Ndryshimet klimatike: çfarë po bën BE-ja”)

ÇFARË KUPTOHET ME “ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM”?



“Zhvillimi i qëndrueshëm është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.”

(Burimi: “Raporti i Komisionit Botëror për Mjedisin dhe Zhvillimin: E Ardhmja Jonë e Përbashkët”)



FAKTE PËRMBLEDHËSE:

- Rhodium Group raportoi se, në vitin 2019, **Kina** ishte emetuesi më i madh i gazeve serrë (27% e gazeve serrë në botë), e ndjekur nga **Shtetet e Bashkuara të Amerikës** (11%) dhe **India** (6.6%). Të marra së bashku, 27 vendet anëtare të Bashkimit Evropian (BE) ishin në vendin e katërt (6.4%).
- Kombet e Bashkuara raportuan se, brenda BE-së, **Gjermania** ishte prodhuesi më i madh i emetimeve të gazeve serrë në vitin 2019, e ndjekur nga **Mbretëria e Bashkuar** (atëherë ende anëtare e BE-së), **Franca**, **Italia**, **Polonia** dhe **Spanja**.
- Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto përqindje kanë ndryshuar historikisht dhe mund të shikojmë se cilat vende kanë kontribuar më shumë në emetimet globale në të kaluarën. Për shembull, duke parë emetimet e dioksidit të karbonit në periudhën **1751-2017**, SHBA-ja mbulonte 25% dhe Kina 12.7% të të ashtuquajturave “emetime kumulative globale”. BE-ja (duke përfshirë edhe Mbretërinë e Bashkuar që ishte pjesë e saj në atë kohë) ka qenë historikisht përgjegjëse për 22% të emetimeve kumulative globale, shumë më të larta se sot. Nga ana tjetër, disa vende që janë emetues të mëdhenj sot (p.sh., India dhe Brazili) nuk kanë qenë emetues të mëdhenj në të kaluarën (duke çliruar përkatësisht vetëm 3% dhe 0.9%).

BASHKIMI EUROPIAN (BE) PO I TRAJTON NDRYSHIMET KLIMATIKE NË NIVEL NDËRKOMBËTAR DHE BRENDË BE-SË.

(1) BE-ja ka kontribuar në zhvillimin e Agjendës së Kombeve të Bashkuara (OKB) 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe është e përkushtuar në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

OKB-ja u themelua në vitin 1945, pas Luftës së Dytë Botërore, për të promovuar paqen dhe sigurinë. OKB-ja tani ka 193 Shtete Anëtare, pothuajse të gjitha vendet në botë. Ata punojnë së bashku për të luftuar ndryshimet klimatike dhe për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm.

Të gjitha Shtetet Anëtare të OKB-së miratuan “Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm” në vitin 2015. Agjenda përfshin 17 “Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm” ose “OZHQ”, të cilat synohen të arrihen deri në vitin 2030. Objektivat kanë të bëjnë me dhënien fund të varfërisë, përmirësimin e jetës dhe mbrojtjen e planetit. Objektivat janë për të gjitha vendet dhe të gjithë njerëzit, dhe qeveritë janë zotuar se “askush nuk do të mbetet prapa”.

Kjo foto tregon 17 Objektivat:



(2) BE-ja ka nënshkruar Marrëveshjen e Parisit për ndryshimet klimatike.

Në vitin 1992, u miratua një marrëveshje e rëndësishme ndërkombëtare për ndryshimet klimatike; u quajt “Konventa Kuadër e OKB-së për Ndryshimet Klimatike”. Tani Konventa ka 197 palë nga e gjithë bota, përfshirë BE-në. Palët në Konventë zakonisht takohen çdo vit në atë që quhet “Konferenca e Palëve” ose “KeP”.

Siç u përmend më lart në listën e Fakteve Përmbledhëse, vendet në mbarë botën kanë nivele të ndryshme përgjegjësie për emetimet e gazeve serrë dhe ambicie të ndryshme. Takimet e KeP-së bashkojnë vendet në përpjekje për të gjetur një rrugë të përbashkët për të ecur përpara. Një pjesë e përpjekjes globale për të luftuar ndryshimet klimatike ka të bëjë me ofrimin e mbështetjes financiare, veçanërisht për të ndihmuar vendet në zhvillim të ndërmarrin veprime dhe kjo njihet si “financimi i klimës”.

Konferenca e 21-të e Palëve për Ndryshimet Klimatike të OKB-së (KEP21) u zhvillua në Paris, nga data 30 nëntor deri më 11 dhjetor 2015. Atje, udhëheqësit botërorë arritën një marrëveshje të rëndësishme ndërkombëtare për ndryshimet klimatike të quajtur “Marrëveshja e Parisit”.

Tani “Marrëveshja e Parisit” ka 193 palë nga e gjithë bota, përfshirë BE-në. Në Marrëveshje, vendet kanë rënë dakord të punojnë për të mbajtur ngrohjen globale nën 2°C, dhe mundësisht në 1,5°C, krahasuar me nivelet para-industriale. Kjo do të ulte në masë të konsiderueshme rreziqet dhe efektet e ndryshimeve klimatike.

(3) BE-ja synon të reduktojë emetimet e gazeve serrë me të paktën 55% deri në vitin 2030, krahasuar me vitin 1990.

Emetimet e gazeve serrë në BE në fakt u ulën me 31% ndërmjet vitit 1990 (viti bazë i zgjedhur) dhe vitit 2020, dhe pritet që ato të vazhdojnë të ulen deri në vitin 2030. Megjithatë, nevojiten më shumë masa nëse BE-ja dëshiron të arrijë objektivin e saj për vitin 2030.

(4) BE-ja gjithashtu synon të jetë neutrale ndaj klimës brenda vitit 2050.

“Kur flasim për luftën kundër ndryshimeve klimatike, ne gjithmonë i referohemi uljes së emetimeve të gazeve serrë. Por, nuk bëhet fjalë vetëm për këtë.

Të bëhesh “neutral ndaj klimës” do të thotë të pakësosh sa më shumë emetimet e gazeve serrë, por do të thotë gjithashtu të kompensosh çdo emetim të mbetur. Kështu mund të arrihet një bilanc neto zero i emetimeve.”

(Burimi: Faqja e internetit e Këshillit Evropian/ Këshillit të BE-së “5 fakte rreth objektivit të BE-së për neutralitetin e klimës”)

Ne mund të pakësojmë emetimet e gazeve serrë, për shembull, duke përdorur lloje më të pastra të energjisë dhe transport më të gjelbër. Megjithatë, disa emetime do të mbeten. Ne mund të përpiqemi të “neutralizojmë” emetimet e mbetura, për shembull, duke u kujdesur për pyjet tona që thithin dioksidin e karbonit të gazit serrë nga atmosfera.



CILAT JANË "5 P-TË" QË IMPAKTOHEN NGA OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM?



1. Personat – “Ne jemi të vendosur t’i japim fund varfërisë dhe urisë, në të gjitha format dhe dimensionet e tyre, si dhe të sigurojmë se të gjitha qeniet njerëzore mund të realizojnë potencialin e tyre me dinjitet dhe barazi në një mjedis të shëndetshëm”.



2. Planeti – “Ne jemi të vendosur të mbrojmë planetin nga përkeqësimi, duke përfshirë konsumin dhe prodhimin e qëndrueshëm, menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të tij natyrore dhe marrjen e masave urgjente ndaj ndryshimeve klimatike, në mënyrë që ai të mund të plotësojë nevojat e brezave aktualë dhe të ardhshëm”.



3. Përparimi – “Ne jemi të vendosur të sigurojmë se të gjitha qeniet njerëzore mund të gëzojnë jetë të begatë dhe përmbushëse, si dhe që përparimi ekonomik, social dhe teknologjik të ndodhë në harmoni me natyrën”.



4. Paqja – “Ne jemi të vendosur për të zhvilluar shoqëri paqësore, të drejta dhe gjithëpërfshirëse, në të cilat të mos ekzistojë frika dhe dhuna. Nuk mund të ketë zhvillim të qëndrueshëm pa paqe dhe nuk ka paqe pa zhvillim të qëndrueshëm”.



5. Partneriteti – “Ne jemi të vendosur të mobilizojmë mjetet e nevojshme për zbatimin e kësaj Agjende nëpërmjet një Partneriteti Global të rigjallëruar për Zhvillim të Qëndrueshëm, bazuar në një frymë solidariteti global të përforcuar, të përqendruar veçanërisht në nevojat e më të varfërve dhe më të prekurve dhe me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve, të gjithë aktorëve dhe të gjithë njerëzve”.

(Burimi: Faqja e internetit të Kombeve të Bashkuara “Transformimi i botës sonë: Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm”)

ÇFARË ISHTË “KEP26”?

Konferenca e 26-të e OKB-së e Palëve për Ndryshimet Klimatike (KeP26) u zhvillua në Glasgow nga data 31 tetor deri më 13 nëntor 2021. Pakti i Glasgout për Klimën u miratua nga të gjitha Palët në Konferencë, duke përfaqësuar pothuajse 200 vende.

Për çfarë u ra dakord?

“Pakti i Glasgout për Klimën mban parasysh vetëm 1.5°C, nëse vendet ndërmarrin veprime të bashkërenduara dhe të menjëhershme për të përmbushur angazhimet e tyre. Kjo do të thotë heqje graduale e energjisë së qymyrit, ndalim i shpyllëzimit dhe pyllëzimit, përshtetje në

automjetet elektrike dhe reduktim i emetimeve të metanit.

“Përpara Parisit, disa shkencëtarë thanë se ekzistonte mundësia që temperaturat të rriteshin përfundimisht deri në 6°C. Angazhimet e marra sipas Marrëveshjes së Parisit e futën botën në drejtimin për një rritje prej 2,7-3,7°C. Nëse premtimet e bëra në Glasgou zbatohen plotësisht, ngrohja do të mbahet nën 2°C; dhe me angazhimin për veprime të mëtejshme gjatë dekadës së ardhshme ne kemi bërë të mundshme 1.5°C.”

(Burimi: “KeP26: The Glasgow Climate Pact”)

ÇFARË ËSHTË “DIPLOMACIA E KLIMËS”?

Përveç ndërmarrjes së masave brenda kufijve të saj, BE-ja po punon gjithashtu për të luftuar ndryshimet klimatike në mbarë botën. Kjo për shkak se BE-ja përbën vetëm një pjesë të emetimeve globale (afërsisht 8%) dhe kështu ndërmarrja e veprimeve brenda BE-së nuk mjafton.

Diplomacia e klimës i referohet punës së BE-së me vendet jo anëtare të BE-së dhe, në nivel global (për shembull nëpërmjet marrëveshjeve si Marrëveshja e Parisit), promovimeve për qëllime dhe veprime ambicioze për ndryshimin e klimës.

ÇFARË ËSHTË “MARRËVESHJA EVROPIANE E GJELBËR”?

Trajtimi i ndryshimeve klimatike është një nga prioritetet dhe synimet kryesore të BE-së dhe Marrëveshja Evropiane e Gjelbër është pjesë e punës së BE-së në këtë fushë. Kjo përshkruhet si “një paketë ambicioze masash që variojnë nga ulja ambicioze e emetimeve të gazeve serrë, tek investimi në kërkimin dhe inovacionin më të avancuar, deri te ruajtja e mjedisit natyror të Evropës”.


(Burimi: Faqja e internetit e Komisionit Evropian “Marrëveshja Evropiane e Gjelbër”)

Ekzistojnë elementë të ndryshëm të Marrëveshjes Evropiane të Gjelbër, duke përfshirë:

1. “Rritja e ambicies klimatike të BE-së për vitin 2030 dhe 2050”
2. “Furnizimi me energji të pastër, të përballueshme dhe të sigurt”

3. “Mobilizimi i industrisë për një ekonomi të pastër dhe qarkulluese”
4. “Ndërtimi dhe rinovimi në mënyrë efikase i burimeve energjitike”
5. “Kalimi i shpejtë drejt transportit të qëndrueshëm dhe inteligjent”
6. “Nga “Ferma në Pjatë”: projektimi i një sistemi ushqimor të drejtë, të shëndetshëm dhe miqësor ndaj mjedisit”
7. “Ruajtja dhe restaurimi i ekosistemeve dhe biodiversitetit”
8. “Ambicie për zero ndotje, për një mjedis pa mbeturina toksike”

(Burimi: Komunikata nga Komisioni Evropian “Marrëveshja Evropiane e Gjelbër” e datës 11 dhjetor 2019)



TEMA 9: ÇFARË PO BËN BE-JA PËR TA BËRË INTERNETIN MË TË SIGURT?

1 PSE KEMI NEVOJË PËR MBROJTJE ONLINE?

Sot, interneti është pjesë e përditshme e jetës së të rinjve evropianë. Fëmijët po rriten duke përdorur pajisje për të luajtur lojëra, për të qenë krijues, për të parë video, për të bërë punë në shkollë, si dhe për t'u lidhur me miqtë dhe familjen. Fëmijët më të rritur mund të përdorin gjithashtu e-mail-in dhe mediat sociale si: Instagram, WhatsApp, TikTok, YouTube dhe Facebook.

Interneti hap dyert për shumë përvoja të reja, inkurajon të mësuarit dhe kreativitetin, si dhe bashkon njerëzit. Megjithatë, **ne kemi nevojë gjithashtu për mbrojtje në internet**, sepse fëmijët dhe të rinjtë mund të ekspozohen ndaj ngacmimit në internet ("**bullizmi kibernetik**"), ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme që janë të dëmshme ose shqetësuese, ndaj lajmeve dhe informacioneve të rreme, ndaj vjedhjes së privatësisë dhe identitetit, si dhe rreziqeve të tjera.

Përveç kësaj, shumë industri dhe fusha të rëndësishme të punës (si: shëndetësia dhe spitalet, energjia, financat dhe bankat, si dhe transporti) varen nga teknologjitë digjitale dhe nga lidhja me internetin për të funksionuar. Në të njëjtën kohë, sulmet dhe krimet në internet ("**sulmet kibernetike**" dhe "**krimet kibernetike**") po shtohen në Evropë dhe janë të nevojshme më shumë veprime për të na mbajtur të sigurt në internet (më shumë "**siguri kibernetike**").

Gjatë **pandemisë COVID-19**, akoma më shumë aspekte të jetës sonë u zhvendosën në internet. Për shembull, mësimet e shkollës, takimet e punës, takimet në lidhje me çështje shëndetësore, lidhjet me miqtë dhe familjen, orët e mësimit me ushtrime – të gjitha këto kanë ndodhur në internet, me anë të telefonatave video Zoom ose FaceTime. Megjithatë, krimi kibernetik u përhap gjithashtu gjatë pandemisë duke treguar nevojën për më shumë siguri në internet. Në fakt, është vlerësuar se sulmet e rëndësishme kibernetike në Evropë janë dyfishuar në vitin 2020, pas pandemisë.




ÇFARË ËSHTË “BULLIZMI KIBERNETIK”?

“Bullizmi kibernetik është ngacmimi duke përdorur teknologjitë digjitale. Ai mund të zhvillohet në mediat sociale, platformat e mesazheve, platformat e lojrave dhe telefonat celularë. Është një sjellje e përsëritur, që synon të frikësojë, zemërojë ose turpërojë ata të cilëve u drejtohet. Këta shembuj përfshijnë:

- përhapjen e gënjeshtreve ose postimi i fotove ose videove të pakëndshme të dikujt në rrjetet sociale;
- dërgimin e mesazheve, imazheve ose videove lënduese, fyese ose kërcënuese nëpërmjet platformave të mesazheve;
- imitimin e dikujt dhe dërgimin e mesazheve të ulëta të tjerëve në emër të tyre ose nëpërmjet llogarive false.

Ngacmimi ballë për ballë dhe bullizmi kibernetik shpesh mund të ndodhin përkrah njëri-tjetrit. Por, bullizmi kibernetik lë një gjurmë digjitale – një gjurmë që mund të jetë e dobishme dhe të sigurojë prova për të ndihmuar në ndalimin e abuzimit.”

(Burimi: Faqja e internetit e Fondit të Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) “Bullizmi kibernetik: Çfarë është dhe si ta ndalojmë”)



ÇFARË ËSHTË “INFORMACIONI I RREMË”?

Ekzistojnë kaq shumë informacione në internet sa nuk është gjithmonë e lehtë të dallohet se çfarë është e vërtetë dhe çfarë jo. Informacioni i rremë mund të jepet rastësisht pa patur si synim shkaktimin e dëmit (“informim i gabuar”) ose mund të jepet me qëllimin për të mashtruar njerëzit dhe për të shkaktuar dëm (“dezinformim”).

Informacioni i rremë në internet, të cilin e kemi parë, për shembull, në lidhje me pandeminë COVID-19 dhe me pushtimin rus të Ukrainës, do të thotë se qenia i vetëdijshëm për problemin është e rëndësishme, sepse jo gjithçka që shihet në internet është reale.

Bashkimi Evropian (BE) thotë se “Përhapja e dezinformimit dhe informacionit të gabuar mund

të ketë një sërë pasojash, të tilla si kërcënimi i demokracive tona, polarizimi i debateve dhe vënia në rrezik e shëndetit, sigurisë dhe mjedisit të shtetasve të BE-së”. (Burimi: Faqja e internetit e Komisionit Evropian “Modelimi i së ardhmes digjitale të Europës: Trajtimi i dezinformimit në internet”). Në një studim të Eurobarometrit të vitit 2018, 85% e të anketuarve mendonin se lajmet e rreme ishin një problem në vendin e tyre dhe 83% e perceptonin atë si një problem për demokracinë në përgjithësi.

Verifikoni nëse lajmi vjen nga një burim i besueshëm dhe i njohur dhe nëse/si po raportohet diku tjetër. Nëse nuk jeni i sigurt se diçka që po shikoni në internet është e vërtetë apo e rreme, pyesni një të rritur që e njihni dhe i besoni që t’ju ndihmojë të zbuloni më shumë.



FAKTE PËRMBLEDHËSE:

- Një anketë nga shoqata “EU Kids Online” në 19 vende evropiane tregoi se shumica e fëmijëve raportojnë se përdorin telefonat ‘smart’ “çdo ditë” ose “pothuajse gjatë gjithë kohës”.
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) vlerëson se 1 në 3 përdorues të internetit në mbarë botën është nën 18 vjeç.
- UNICEF-i gjithashtu raporton se të rinjtë (mosha 15-24) janë grupmosha më e lidhur dhe se në mbarë botën 71% janë online, krahasuar me 48% të popullsisë totale. Megjithatë, të rinjtë në Afrikë janë më pak të lidhur dhe rreth 60% nuk janë online, krahasuar me vetëm 4% që nuk janë online në Europë.
- Rezultatet e një ankete (të publikuar në vitin 2019 nga UNICEF-i dhe Përfaqësuesi i Posaçëm i OKB-së për Dhunën ndaj Fëmijëve) treguan se 1 në 3 të rinj në 30 vende raportoi se ka qenë viktimë e bullizmit në internet; dhe 1 në 5 raportoi se kishte munguar në shkollë për shkak të bullizmit dhe dhunës në internet.
- Në anketë, pothuajse $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e të rinjve thanë gjithashtu se rrjetet sociale janë vendi më i zakonshëm për bullizmin online.
- Ne e diskutuam ndryshimin e klimës në një fletë tjetër informuese dhe këtu është mirë të mendojmë për përdorimin e energjisë dhe emetimet e gazeve serrë të lidhura me aktivitetin tonë në internet, sepse afërsisht 4.1 miliardë njerëz, ose 53.6% e popullsisë së botës, tani përdorin internetin. Disa janë të mendimit se pajisjet tona, interneti dhe sistemet e ndryshme mbështetëse përbëjnë rreth 3.7% të emetimeve globale të gazeve serrë! Disa kompani interneti po përpiqen të jenë më miqësore me mjedisin, për shembull, duke përdorur burime të rinovueshme të energjisë. Ju gjithashtu mund të ndihmoni, për shembull, duke menduar me kujdes përpara se të blini telefonin më të fundit dhe duke përdorur modalitetin e kursimit të energjisë në pajisjet tuaja.



2 ÇFARË MUND TË BËJMË PËR TË QENË TË SIGURT ONLINE?

Prindërit tuaj mund të vendosin fjalëkalime, kontrole prindërore, konfigurime të sigurta kërkimi dhe programe për mbrojtjen nga viruset për të ndihmuar që pajisjet (si: telefonat smart, orët smart, tabletat, laptopët dhe kompjuterët etj.) dhe interneti të jenë më të sigurt për ju. Ata gjithashtu mund t'ju ndihmojnë ta mbani të sigurt informacionin tuaj personal, të përdorni motorë kërkimi të sigurt dhe të gjeni faqe interneti, lojëra dhe aplikacione të përshtatshme.

Ka edhe disa gjëra që mund të bëni vetë për të qenë të sigurt në internet. Për shembull:



1. Ndjekja e rregullave të rëna dakord me prindërit për atë që mund të bëni në internet dhe sa kohë mund të kaloni në internet. Gjithashtu, platformat e mediave sociale, lojërat dhe aplikacionet kanë kritere për moshën, kështu që kontrolloni nëse e përmbushni moshën para se të regjistroheni.



7. Shikoni të vendosni profilet tuaja në konfigurimin privat (dhe pyetni një të rritur nëse nuk dini si ta bëni këtë).



8. Sigurohuni që të dini të bllokoni, çaktivizoni dhe raportoni njerëzit ose përmbajtjet që ju shqetësojnë (dhe pyetni një të rritur nëse nuk dini si ta bëni këtë).



2. Ndjekja e rregullave të rëna dakord me prindërit tuaj në lidhje me informacionin që mund të jepni në internet për t'ju ndihmuar të ruani të sigurt identitetin dhe informacionin tuaj personal.



9. Jini të vetëdijshëm për “informacionet e rreme”, sepse jo gjithçka që shikoni në internet është e vërtetë. Nëse nuk jeni i sigurt se diçka që po shikoni në internet është e vërtetë apo e rreme, pyesni një të rritur që e njihni dhe i besoni për të mësuar më shumë.



3. Zgjedhja e fjalëkalimeve tuaja me zgjuarsi dhe mostregimi i tyre asnjëherë.



10. Mendohuni mirë para se të klikoni – Mos klikoni lidhje ose mos shkarkoni gjëra që nuk i njihni dhe kërkoni ndihmë, nëse nuk jeni të sigurt.



4. Bisedat dhe lidhja në internet vetëm me miqtë dhe familjen e vërtetë. Gjithashtu, mos harroni të jeni një mik i mirë në internet, siç do të bënit në pjesën tjetër të jetës tuaj.



11. Bëni një pushim dhe kaloni pak kohë pa parë ekranin. Gjithashtu, mos harroni se jeni më shumë sesa thjesht numri juaj i “pëlqimeve” në mediat sociale.



5. Asnjëherë mos organizoni takim në jetën reale me dikë me të cilin keni folur vetëm në internet – Disa njerëz mund të mos jenë ata që thonë se janë. Ndonjëherë fëmijët dhe të rinjtë mashtrohen dhe takohen me njerëz që mund t'i dëmtojnë.



12. Mos harroni, nëse keni ndonjë problem në internet ose keni ndonjë shqetësim, kërkoni ndihmë nga prindërit, mësuesit ose një të rritur që e njihni dhe i besoni. Përdorni pajisjet tuaja në një hapësirë të përbashkët si dhoma e ndenjes ose kuzhina, në mënyrë që të mund të merrni ndihmë nëse është e nevojshme.



6. Mendohuni para se të publikoni në internet – Çdo gjë që hidhni në internet (si komentet, mesazhet, videot ose fotot) mund të shpërndahet ose ruhet nga dikush tjetër (si p.sh. duke kopjuar pamjen e ekranit), ose mund të bjerë në duar të gabuara.



DITA E INTERNETIT TË SIGURT

Dita e Internetit të Sigurt (DIS) festohet çdo shkurt në rreth 200 vende dhe territore anembanë botës. Tema e DIS-it në vitin 2022 ishte “Së bashku për një internet më të mirë” dhe ka të bëjë me inkurajimin e të gjithëve që të bashkohen për ta bërë internetin një vend më të sigurt për të gjithë, veçanërisht për fëmijët dhe të rinjtë.

ÇFARË ËSHTË “GJURMA DIGJITALE”?

“Sa herë që vizitoni një faqe interneti, hidhni një foto ose bëni një koment në internet, ju lini një gjurmë digjitale që njerëzit e tjerë mund ta shohin. Gjurma juaj digjitale përfshin të gjithë informacionin që ndani ose që është mbledhur për ju në internet dhe mund të ketë shumë të tilla.

Shumë nga informacionet që ju hidhni mund të shihen nga njerëz të tjerë. Kjo mund të përdoret për t’u dërguar reklama, ose mund të shikohet nga një punëdhënës i mundshëm vite më vonë. Ndonjëherë njerëzit mund të përdorin detajet që ju hidhni për të përcaktuar identitetin tuaj.

Gjurma juaj mund të jetë si e mirë, ashtu edhe e keqe. Mund të tregojë gjëra për të cilat më vonë mund t’ju vijë turp, ose t’i ndihmojë njerëzit të shohin aftësitë tuaja ose gjërat për të cilat jeni krenarë.”

(Burimi: Faqja e internetit e Childline UK “Kujdesi për privatësinë dhe gjurmën tuaj dixhitale”)

3

ÇFARË BËN BE-JA QË INTERNETI TË JETË MË I SIGURT?

Një nga synimet kryesore të Bashkimit Evropian (BE) është të ndihmojë Evropën të bëhet e përshtatshme dhe e gatshme për epokën digjitale. Një pjesë e kësaj ka lidhje me bërjen e internetit një vend më të sigurt për të gjithë. Këtu do të diskutojmë katër shembuj të hapave që ka ndërmarrë BE-ja:

1. RREGULLAT E BE-SË SI RREGULLORJA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE (RPMD)

Kur hyjmë në internet, shpesh i japim informacione personale (si: emrin, adresën, adresën tonë të emailit, vendndodhjen, etj.) ofruesit tonë të internetit dhe faqes së internetit që po vizitojmë. Rregullat e BE-së mund të ndihmojnë në mbrojtjen e privatësisë dhe të dhënave tona kur futemi në internet.

Rregullorja e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave (RPMD) është ligji i BE-së për mbrojtjen e të dhënave. Ai synon të sigurojë që të dhënat tona personale të mblidhen dhe menaxhohen në mënyrë korrekte dhe të mos keqpërdoren. RPMD-ja është përshkruar si “ligji më i ashpër i privatësisë dhe sigurisë në botë”.

2. KARTA E BE-SË PËR TË DREJTAT THEMELORE

Përveç kësaj, ne diskutojmë mbi Kartën e BE-së për të Drejtat Themelore në një fletë tjetër informuese. Ajo përmban të drejtat themelore të secilit në BE dhe parashikon se “Çdokush ka të drejtën e mbrojtjes së të dhënave personale të tij/të saj”.



3. INTERNET MË I MIRË PËR FËMIJËT

Në vitin 2012, BE-ja përcaktoi një “Strategji Evropiane për një Internet më të Mirë për Fëmijët”. Në kuadrin e Strategjisë zhvillohen aktivitete të ndryshme dhe ajo ka ndikuar gjithashtu në masat e marra në vendet anëtare të BE-së.

Për shembull, BE-ja financo platformën “Internet më i Mirë për Fëmijët”, e cila synon të krijojë një internet më të sigurt dhe më të mirë për fëmijët dhe të rinjtë. Platforma ofron informacion, udhëzime dhe burime mbi çështjet për një internet më të mirë.

BE-ja gjithashtu bashkë-financo “Qendrat e Internetit më të Sigurt” (QIS). Ato veprojnë në Shtetet Anëtare të BE-së dhe gjithashtu në Islandë, Norvegji dhe Mbretërinë e Bashkuar. QIS-et zakonisht ofrojnë një qendër ndërgjegjësimi, linjë ndihme, linjë telefonike dhe panel për të rinjtë.

4. SIGURIA KIBERNETIKE

Siguria kibernetike ka të bëjë me sigurinë tonë në internet dhe është një nga qëllimet më të rëndësishme të BE-së.

BE-ja po ndërmerr veprime të ndryshme për të forcuar sigurinë tonë në internet, duke përfshirë:

- Në BE ka një “Strategji e BE-së për Sigurinë Kibernetike”, e cila mbulon sigurinë e shërbimeve të rëndësishme si: spitalet, rrjetet e energjisë dhe hekurudhat, si dhe pajisjet në shtëpi dhe në punë.
- Në BE ka ligje të ndryshme për sigurinë kibernetike.
- Ekziston një Agjenci e BE-së për Sigurinë Kibernetike (ENISA), e cila ndihmon shtetet anëtare, institucionet e BE-së dhe të tjerët si të trajtojnë sulmet kibernetike.
- Për të ndihmuar vendet e BE-së të luftojnë krimet në internet ekziston një Qendër Evropiane e Krimit Kibernetik.

- Qendrat kombëtare të ndërgjegjësimimit punojnë për të rritur ndërgjegjësimin mbi përpjekjet për një internet më të sigurt tek fëmijët, të rinjtë, prindërit dhe mësuesit.
- Linjat e këshillimit ofrojnë informacione, këshilla dhe ndihmë për fëmijët, të rinjtë dhe prindërit në lidhje me trajtimin e përmbajtjes, kontaktit ose sjelljes së dëmshme (si p.sh. bullizmi kibernetik).
- Linjat telefonike të përhershme u mundësojnë anëtarëve të publikut të raportojnë përmbajtje të paligjshme në internet në mënyrë anonime (pa dhënë emrin e tyre).
- Grupet rinore të debatit ofrojnë një mundësi që të rinjtë të japin pikëpamjet dhe të ndajnë përvojat e tyre në lidhje me përdorimin e internetit dhe këshilla për të qenë të sigurt në internet.

ÇFARË JANË “SULMET KIBERNETIKE”?

“Përveç mundësive të reja, kalimi në një botë digjitale më intensive ka sjellë gjithashtu kërcënime të reja në formën e sulmeve kibernetike. Sulmet kibernetike përdoren për të vjedhur të dhëna, për të spiunuar përdoruesit, për të çaktivizuar ose manipuluar kompjutera dhe shumë më tepër. Ato synojnë jo vetëm kompjutera personalë, por edhe rrjete të tëra dhe mund të kryhen nga hakerë individualë, grupe hakerash, apo edhe shtete.

Që lëvizja drejt botës digjitale të jetë e suksesshme, qytetarët dhe bizneset evropiane duhet të përfitojnë nga teknologjitë e reja pa kompromentuar sigurinë e tyre kibernetike. Strategjia e BE-së për Sigurinë Kibernetike synon të forcojë sigurinë tonë kolektive kibernetike dhe reagimin tonë ndaj sulmeve kibernetike. Ajo do të ndërtojë një internet global të qëndrueshëm dhe të sigurt, ku të mbrohet shteti i së drejtës, të drejtat e njeriut dhe vlerat demokratike.”

(Burimi: Faqja e internetit e Komisionit Evropian “Modelimi i së ardhmes digjitale të Europës: Siguria kibernetike”)

ÇFARË ËSHTË “KRIMI KIBERNETIK”?

“Krimi kibernetik përbëhet nga akte kriminale të kryera në internet duke përdorur rrjetet e komunikimeve dhe sistemet elektronike të informacionit.”

“Krimi kibernetik është një çështje që i kalon kufijtë, që mund të klasifikohet në tre përkufizime të gjera:

- krime specifike në internet...
- mashtrim dhe falsifikim në internet...
- përmbajtje e paligjshme në internet...”.

(Burimi: Faqja e internetit e Komisionit Evropian “Migracioni dhe Çështjet e Brendshme: Krimi Kibernetik”)



4


PO TË DREJTAT E FËMIJËVE NË BOTËN E INTERNETIT?

Në një fletë tjetër informuese, diskutuam për të drejtat e fëmijëve dhe se si, mbi 30 vjet më parë, në vitin 1989, udhëheqësit botërorë miratuan **Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve**.

Konventa është një marrëveshje ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe 196 vende, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të BE-së, e kanë nënshkruar këtë marrëveshje. Konventa shpjegon se fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç dhe se të gjithë fëmijët duhet të gëzojnë të gjitha të drejtat e renditura në Konventë.

Në mars të vitit 2021, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve miratoi një dokument të rëndësishëm të quajtur “**Komenti i Përgjithshëm nr. 25 mbi të drejtat e fëmijëve në lidhje me mjedisin digjital**”.

Miratimi i Komentit të Përgjithshëm e bën të qartë se të drejtat e fëmijëve zbatohen edhe në botën e internetit. Në Komentin e Përgjithshëm, Komiteti shpjegon se si shtetet palë duhet ta zbatojnë Konventën në lidhje me mjedisin digjital.



TEMA 10: SI E MBËSHTET BE-JA ARSIMIN DHE TRAJNIMIN TIM?

1

PSE ËSHTË I RËNDËSISHËM ARSIMI?

Siç e kemi diskutuar në një fletë tjetër informuese, **arsimi është një e drejtë e njeriut**, që do të thotë se të gjithë kanë të drejtën për arsim. Kjo e drejtë është e përcaktuar në **Deklaratën Universale të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara** (DUDNJ), si dhe në **Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës** (KDF). Të gjithë fëmijët kanë të drejtën për arsim pavarësisht se kush janë: pavarësisht nga raca, feja, gjinia ose aftësitë e kufizuara, nëse jetojnë me familjen ose në një qendër rezidenciale (shtëpi fëmijësh), apo janë refugjatë. KDF-ja parashikon se arsimi fillor duhet të jetë i detyrueshëm dhe falas për të gjithë.

Përveç kësaj, e drejta për arsim mbrohet nga **Karta e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore**, të

cilën e kemi diskutuar në një fletë tjetër informuese. Karta përmban të drejtat themelore të secilit brenda Bashkimit Evropian (BE) dhe Neni 14 i Kartës ka të bëjë me të drejtën për arsim.

Përmirësimi i arsimit dhe trajnimit të fëmijëve është shumë i rëndësishëm. **Fëmijët që arsimohen mund të kenë më shumë mundësi për të arritur qëllimet e tyre** dhe për të realizuar potencialin e tyre. Aksesimi në arsim dhe trajnim cilësor është gjithashtu i rëndësishëm për **rritjen ekonomike** të një vendi, sepse të rinjtë mund të zhvillojnë aftësi, njohuri dhe ide të reja të cilat mund t'i përçojnë në botën e punës.

4 EDUKIM
KUALITATIV



SI ZBATOHEN “OBJEKTIVAT E ZHVILLIMIT TË QËNDRUESHËM” TË KOMBEVE TË BASHKUARA ?

Ne i diskutuam “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” ose “OZHQ-të” e Kombeve të Bashkuara në një fletë tjetër informuese. Objektivat kanë të bëjnë me eliminimin e varfërisë, përmirësimin e jetës dhe mbrojtjen e planetit. Objektivat janë për të gjitha vendet dhe të gjithë njerëzit, dhe qeveritë kanë premtuar t'i përmbushin ato në mënyrë që “askush të mos mbetet prapa”.

Objektivi 4 ka të bëjë me sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë dhe për promovimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës. Objektivi 4 është i rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm, sepse arsimi mund të ndihmojë në nxjerrjen e familjeve nga varfëria, uljen e pabarazive dhe promovimin e paqes.

BE-ja është e përkushtuar për zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm.



FAKTE PËRMBLEDHËSE:

- Në vitin 2020 ka patur rreth 1.3 miliardë fëmijë të moshës shkollore në mbarë botën (5-14 vjeç). Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (UNICEF) raporton se në mbarë botën mbi 1 miliard fëmijë shkojnë në shkollë çdo ditë mësimi.
- Megjithatë, UNICEF-i ka raportuar gjithashtu se 617 milionë të rinj në mbarë botën (fëmijë të moshës së shkollës fillore dhe adoleshentë të moshës së shkollës së mesme) nuk kanë aftësi bazë matematikore dhe për shkrim-lexim.
- Gjithashtu, sipas UNICEF-it rreth 262 milionë fëmijë dhe të rinj (fëmijë të moshës së shkollës fillore dhe të mesme) nuk kanë qenë në shkollë në vitin 2018 – që është pothuajse një në pesë fëmijë në popullsinë botërore në atë grupmoshë.
- Ai ka vënë gjithashtu në dukje se më shumë se gjysma e fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollë jetojnë në Afrikën Sub-Sahariane.
- OKB-ja ka vënë në dukje gjithashtu se, në mbarë botën, rreth 5.5 milionë vajza të moshës së shkollës fillore më shumë sesa djem nuk ishin në shkollë në vitin 2018.

Burimi: Faqja e internetit të UNICEF-it dhe Strategjia e UNICEF-it për Arsimin 2019–2030.



2 SI E MBËSHTET BE-JA ARSIMIN TIM?

Sistemet e arsimit dhe trajnimit në BE organizohen dhe ofrohen nga vetë vendet anëtare të BE-së, por ato i mbështet edhe BE-ja. Për shembull, **BE-ja i ndihmon shtetet anëtare** të krijojnë ide të reja për sistemet e tyre të arsimit dhe trajnimit, duke mbështetur financiarisht projekte që synojnë promovimin e ideve dhe kërkimin e metodave të reja të trajnimit, temave të reja për kurrikulat ose futjen e teknologjisë në shkolla.



FAKTE PËRMBLEDHËSE NË LIDHJE ME PROGRAMIN “ERASMUS”

ERASMUS është programi i BE-së për arsimin, trajnimin, rininë dhe sportin në Evropë, i krijuar në vitin 1987. Ai ofron mundësi lëvizjeje dhe bashkëpunimi, duke përfshirë edukimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme, arsimin e lartë dhe trajnimin profesional. ERASMUS+ është një version më gjithëpërfshirës, digjital dhe më i gjelbër (2021-2027) i ERASMUS-it.

- Sipas Komisionit të BE-së, ERASMUS-i është shkurtimi i emërimit Skema e Veprimit në

Ekzistojnë gjithashtu mundësi për të rinjtë brenda BE-së që të **studiojnë dhe të mësojnë në vende të tjera të BE-së**, për shembull, në universitete anembanë Evropës si pjesë e programit ERASMUS, dhe që ato periodikisht arsimi të tyre të njihen në vendin e tyre. Gjithashtu, certifikatat, diplomat ose kualifikimet e marra në një vend anëtar të BE-së përgjithësisht njihen dhe janë të vlefshme në vendet e tjera anëtare. Për arsimin në nivel universitar, kjo është arritur nëpërmjet të ashtuquajturit “Proces i Bolonjës” ku shtetet anëtare kanë rënë dakord të rrisin koherencën e sistemeve të arsimit të lartë në të gjithë Europën.

Rajonin Evropian për Lëvizjen e Studentëve të Universitetit. Programi është emërtuar gjithashtu sipas filozofit holandez Desiderius Erasmus nga Rotdami (1465-1536), i cili udhëtoi për punë dhe studime në qendrat e arsimit në të gjithë Evropën, duke përfshirë Parisin, Leuvenin dhe Kembrixhin.

- Në vitin e parë të programit, jashtë vendit studiuan vetëm 3244 studentë, ndërsa tani janë mbi 10 milionë pjesëmarrës.
- ERASMUS+ ka një buxhet të parashikuar prej 26.2 miliardë Euro, që është pothuajse dyfishi i financimit të programit pararendës (2014-2020).
- Në vitin 2020, buxheti i ERASMUS-it prej 3.8 miliardë Eurosh financoi trajnimin dhe studimet jashtë vendit të rreth 640.000 personave, aktivitetet e 126.000 organizatave dhe rreth 20.400 projekteve.

Siç kemi diskutuar në një tjetër fletë informuese, 27 vendet anëtare të BE-së punojnë së bashku në nivel BE-je për të zgjidhur çështjet që prekin të gjithë ata që jetojnë në BE. Ato përpiqen të kapërcejnë mosmarrëveshjet e tyre për të trajtuar së bashku sfidat e rëndësishme. Për shembull, BE-ja po shpenzon para për arsimin në vendet anëtare në mënyrë që të trajtojë ndikimin e

sfidave globale, të tilla si: hendeku në aftësitë teknologjike midis vendeve të pasura dhe të varfra, ndryshimet klimatike, njerëzit që detyrohen të largohen nga shtëpitë e tyre dhe konfliktet. Duke shpenzuar para për arsimin e fëmijëve, BE-ja dhe vendet anëtare të saj po përpiqen të ndërtojnë shoqëri gjithëpërfshirëse, më të gjelbra, më të sigurta dhe më të qëndrueshme.

ROLI I EDUKIMIT NË TRAJTIMIN E SFIDAVE GLOBALE



AFTËSITË DIGJITALE

Siç kemi diskutuar në një fletë tjetër informuese, interneti është një pjesë e përditshme e jetës së të rinjve evropianë dhe shumë aspekte të jetës sonë janë zhvendosur në internet. Aftësitë digjitale (të tilla si: aftësia për të përdorur kompjuter dhe internet) janë thelbësore sot për të pasur sukses në shoqërinë botërore të orientuar nga teknologjia. Arsimi luan një rol kryesor në zhvillimin e këtyre aftësive për jetën dhe punën. Një edukim i mirë garanton që të rinjtë të jenë gati për epokën digjitale.



MIGRIMI, LUFTA DHE KONFLIKTI

Ne kemi diskutuar mbi migrimin në një fletë tjetër informuese. Miliona fëmijë transferohen me familjet e tyre për shkak të konfliktit, varfërisë ose fatkeqësive të lidhura me

motin dhe motin ekstrem. Shkollat mund të jenë vende të sigurta për fëmijët dhe arsimi ndihmon në mbrojtjen e tyre nga kërcënimet, duke përfshirë punën e fëmijëve, detyrimin për të lëvizur nga vendet e tyre kundër vullnetit dhe keqtrajtimin. Në shoqëritë ku ka luftë dhe konflikt, arsimi mund të ndihmojë në promovimin e tolerancës dhe paqes, si dhe mund të ndihmojë në ndaljen e ciklit të dhunës.



KRIZA KLIMATIKE

I kemi diskutuar ndryshimet klimatike në një fletë tjetër informuese. Kriza klimatike është një nga sfidat më të mëdha të kohës sonë, prandaj është shumë e rëndësishme t'u mësohen fëmijëve çështjet mjedisore dhe si t'i trajtojnë ato. Për shembull, edukimi rreth ndryshimeve klimatike mund t'i ndihmojë fëmijët dhe të rinjtë të kuptojnë rëndësinë e përdorimit të burimeve të energjisë miqësore me mjedisin.

BE-ja po ndihmon për të krijuar atë që quhet “Zona Evropiane e Arsimit”, e cila do të ndihmojë të gjitha vendet anëtare të BE-së të përmirësojnë sistemet e tyre arsimore. Gjithashtu, BE-ja ka krijuar atë që quhet “Koalicioni i Arsimit për Klimën” për të ndihmuar në trajtimin e krizës klimatike.

Tani do t'i shikojmë këto dy nisma më në detaje.

3

ÇFARË ËSHTË ZONA EVROPIANE E ARSIMIT?

Siç u përmend më lart, BE-ja po krijon “Zonën Evropiane të Arsimit” për të ndihmuar vendet anëtare ta bëjnë arsimin dhe trajnimin më të mirë për të gjithë në BE. Plani arsimor i BE-së është të sigurojë që të gjithë fëmijët të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe të përfshihen në shoqëri. BE-ja dëshiron që vendet anëtare të punojnë më shumë së bashku kur të planifikojnë sistemet e tyre të arsimit dhe trajnimit. Një shembull është që BE-ja dëshiron të sigurohet se të gjithë studentët kanë mundësi të mësojnë dhe të flasin gjuhë të ndryshme. Zona e re Evropiane e Arsimit do të përqendrohet në krizën klimatike dhe teknologjinë digjitale, si dhe do të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën demokratike.




FAKTE PËRMBLEDHËSE:

Rreth 76.2 milionë nxënës dhe studentë janë regjistruar në shkolla dhe institucione parashkollore në BE në të gjitha nivelet e arsimit.

Ideja e “Zonës Evropiane të Arsimit” u zhvillua për herë të parë nga udhëheqësit evropianë në Samitin Social 2017 në Gotenburg, Suedi, por bashkëpunimi ka vazhduar për dekada me rradhë. Si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet vendeve anëtare të BE-së, situata në BE është si vijon më poshtë:

- Pothuajse 95% e fëmijëve ndjekin arsimin në fëmijërinë e hershme që nga mosha 4 vjeçare.
- Më shumë se 40% e të rinjve fitojnë një kualifikim të arsimit të lartë.
- Pothuajse 90% e të rinjve largohen nga arsimi me një diplomë të mesme ose me regjistrim në trajnim.
- 80% e të sapodiplomuarve të ERASMUS+ fitojnë punësim në më pak se 3 muaj pas diplomimit.

BE-ja po punon gjithashtu për të siguruar përparim të mëtejshëm në uljen e përqindjes së 15-vjeçarëve me aftësi të ulët në lexim, matematikë dhe shkencë, si dhe në rritjen e pjesëmarrjes së të rriturve në mësim.



SI NDIKOI PANDEMIA COVID-19 NË ARSIMIN E FËMIJËVE DHE ÇFARË PO BËN BE-JA PËR KËTË?

Shumë fëmijëve në BE u është dashur të ndryshojnë mënyrën e studimit për shkak të pandemisë COVID-19. Për shembull, shumë fëmijëve u është dashur të studiojnë në shtëpi dhe jo në shkollë. Megjithatë, jo të gjithë fëmijët dhe të rinjtë kanë pasur akses në të mësuarin në distancë dhe jo me të njëjtën cilësi.

Meqenëse pandemia COVID-19 ka pasur një ndikim të madh në arsim, Zona Evropiane e Arsimit lidhet me një plan për të ndihmuar vendet anëtare të BE-së të rikuperojnë nga pandemia COVID-19. Ky plan quhet “BE-ja e Brezit Tjetër”. Plani “BE-ja e Brezit Tjetër” do të investojë në sistemet arsimore

BE-ja shpreson ta bëjë realitet Zonën Evropiane të Arsimit brenda vitit 2025. Për ta arritur këtë, BE-ja synon:

- **Promovimin e cilësisë**, duke përmirësuar aftësitë bazë si: sipërmarrja, kreativiteti dhe aftësia për të përdorur teknologjinë e re, si dhe duke promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar ndërmjet institucioneve arsimore.
- **Inkurajimin e mësimin të gjuhës** dhe shumë-gjuhësinë, si dhe mbështetjen e zbulimit dhe menaxhimit të diversitetit kulturor.
- **Promovimin e arsimit gjithëpërfshirës dhe barazisë** ndërmjet grave dhe burrave në të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimit. Një shembull është trajtimi i sjelljes seksiste dhe sjelljes së papërshtatshme seksuale në arsim dhe trajnime. BE-ja punon gjithashtu për barazinë ndërmjet burrave dhe grave në pozicione drejtuese, duke përfshirë institucionet e arsimit të lartë, si dhe profesionet në të cilat burrat dhe/ose gratë janë të përfaqësuar në mënyrë të pabarabartë.
- **Ndihmën për studentët, në mënyrë që ata të përgatiten për një të ardhme të re “të gjelbër”** duke u siguruar se arsimi dhe trajnimi profesional përshtaten me tranzicionin e gjelbër dhe atë digjital.

4

ÇFARË ËSHTË ARSIMI PËR KOALICIONIN KLIMATIK?


Kemi diskutuar në lidhje me ndryshimin e klimës në një fletë tjetër informuese. BE-ja po përpaket ta përdorë arsimin për të ndihmuar në mbrojtjen e mjedisit dhe për të luftuar krizën klimatike. Për ta bërë këtë, siç u përmend më lart, BE-ja po krijon një “Koalicion Arsimit për Klimën”. Koalicioni i Arsimit për Klimën synon të krijojë një komunitet të udhëhequr nga mësues dhe studentë, të cilët do të mësojnë nga njëri-tjetri dhe do të ndajnë idetë për të ndihmuar në trajtimin e krizës klimatike. BE-ja dëshiron të japë mbështetje financiare (të tilla si para) për mundësitë e arsimit dhe trajnimit që do të kontribuojnë në mbrojtjen e mjedisit. Për shembull, BE-ja dëshiron të ndihmojë shkollat që të përdorin kurse shkencore për t’i mësuar nxënësit në lidhje me mbrojtjen e mjedisit.

Gjithashtu, kriza klimatike po ndryshon llojet e punëve që bëjnë njerëzit dhe shumë vende duan që njerëzit të punojnë në pozicione të tilla që nuk dëmtojnë mjedisin. BE-ja dëshiron gjithashtu të sigurohet se qytetarët e BE-së mund të punojnë në këto punë miqësore me mjedisin, duke u mësuar atyre aftësitë që do t’u nevojiten për ta bërë këtë.



BOTIME TË TJERA TË PROJEKTIT GJENDEN NË ADRESËN:

[HTTPS://RECONNECT-EUROPE.EU/PUBLICATIONS/](https://reconnect-europe.eu/publications/)



RECONNECT

Këto fletë informuese u përgatitën nga Qendra Bingham për Shtetin e së Drejtës së bashku me Universitetin e Leuvenit, si pjesë e projektit RECONNECT të financuar nga BE Horizon 2020, “Të rilidhim Evropën me qytetarët e saj nëpërmjet demokracisë dhe shtetit të së drejtës”. Ato janë hartuar për të ofruar materiale edukative mbi vlerat thelbësore evropiane dhe konceptet kryesore për të rinjtë që jetojnë në Bashkimin Evropian. Projekti ka marrë financim nga programi “Kërkim dhe Inovacion Horizon 2020” i Bashkimit Evropian sipas Grantit nr. 770142.

Botimi në shqip i Ministrisë së Drejtësisë është bërë i mundur nga projekti i asistencës teknike “JUSTAL” në mbështetje të zbatimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë, financuar nga Bashkimi Evropian.

